

The page features a decorative graphic consisting of several overlapping blue circles of varying sizes and shades, arranged in a diagonal line from the top right towards the bottom right. A thin blue line also runs diagonally across the page, intersecting the circles.

# **Situata social-ekonomike e grave në Kukës**

**Kushtet dhe mundësitë**

**Ky studim është një përpjekje për të sjellë një “fotografim” të situatës së grave në Kukës nën ndikimin e faktorëve të zhvillimit.**

**RSL  
Janar 2012**

SITUATA  
SOCIALE DHE EKONOMIKE  
E  
GRAVE NË KUKËS



Rinia në Sipërmarrjen e Lire, Kukës

25 Janar 2012

*Hartuar nga:*

*Rifat Demalija, Doktorant*

*Lavdrim Shehu, MND*

*Ardita Baji, LLM*

*Doriana Gjuta, MPA*

***Mbështetur nga Open Society Foundation, albania***



*Qëndrimet në këtë studim janë përgjegjësi vetëm të hartuesve të tij dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e OSFA*

PARATHËNIE	..... 3
FALENDERIME	..... 3
LISTA E SHKURTIMEVE	.....4
<b>KAPITULLI I PARË: Përshkrim i përgjithshëm i Studimit</b>	
I.I. Objektivat e studimit	..... 5
I.II. Metodologjia e studimit	..... 5
I.III. Probleme dhe kufizime	..... 6
I.IV. Përkufizimet e përdorura	..... 6
I.V. Zona e marrë në studim	..... 7
<b>KAPITULLI I DYTË: Zhvillimi social dhe ekonomik</b>	
II.I. Demografia dhe lëvizjet migratore	..... 8
II.II. Situata ekonomike	..... 9
II.III. Tregu i punës	..... 11
II.IV. Mirëqënia Sociale dhe Mbrojtja Shoqërore	.....13
II.V. Arsimi	.....13
II.VI. Shëndetësia	.....15
II.VII. Politikat institucionale dhe projekte në fushën e barazise gjinore	.....15
II.VIII. OJF-të dhe Media	.....16
<b>KAPITULLI I TRETË: Përfshirja dhe përjashtimi social</b>	
III.I. Koncepte mbi Përjashtimin Social	.....20
III.II. Ndikimi i varfërisë në përjashtimin social të grave në Kukës	.....21
III.III. Përfshirja e grave në vendim-marrje	.....22
III.IV. Politikat sociale për përfshirjen e grave në nivel vendor	.....24
III.V. Të drejtat e grave, legjislacioni, mekanizmat referues; (ref dokumenta dhe ligje)	.....25
<b>KAPITULLI I KATËRT: Vlerësim i situatës dhe gjetjet</b>	
IV.I. Mundësitë për të ardhura financiare të grave	.....27
IV.II. Varfëria	.....28
IV.III. Angazhimi në biznese i grave	.....29
IV.IV. Grupet e grave me probleme të veçanta	.....29
IV.V. Gjetjet nga grupet e fokusuar, intervistat dhe pyetsorët	.....30
REKOMANDIME	.....44
BIBLIOGRAFI	.....47
SHTOJCA	.....48
LISTA E TABELAVE	.....50

## **PARATHËNIE**

Ky studim erdhi si nevojë për të vlerësuar situatën social ekonomike dhe për të identifikuar nevojat për vajzat dhe gratë në Kukës. Për vetë specifikën dhe raportin social ku gjenden gratë dhe vajzat në Qarkun e Kukësit, dhe pavarësisht ndërhyrjeve në legjislacion apo kodin zgjedhor, ky grup social gjendet i përjashtuar dhe i papërfaqësuar ashtu siç duhet.

Mungesa e barazisë gjinore dhe përfaqësimit, kërkon më shumë vëmendje dhe mbështetje në implemtimin e strategjive dhe legjislacionit në fuqi nga të gjithë aktorët së bashku. Gjithashtu, ky studim sjell në vëmendje se situata pafavorizuese e vajzave dhe grave, duhet marrë në konsideratë nga vetë grupi, me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe pjesëmarrjen aktive të tyre në shoqëri, përndryshe situata mund të vazhdojë të mbetet e ngjashme edhe në vazhdim.

Pavarësisht, punës dhe kontributeve që ky studim ka sjellë në vëmendje të aktorëve të interesuar në këtë fushë dhe atyre të cilët kanë detyrime ligjore për të ndihmuar në zbutjen e kësaj situatë, prapëseprapë, nuk pretendojmë të kemi çelsin për zgjidhjen e problematikës, sikurse mbetet shumë për tu bërë edhe në përmirësimin e studimeve të ngjashme, duke sjellë sa më shumë kontribute dhe të dhëna të cilat mund të ndihmojnë aktorët e përfshirë në përmirësimin e jetës së grave dhe vajzave në Qarkun e Kukësit.

## **FALENDERIME**

Ky studim u mundësua nga mbështetja e OSFA Tiranë.

Një mirënjohje dhe falenderim të veçantë për këtë studim u drejtohet të rejave e të rinjëve vullnetarëve të shoqatës “Rinia në Sipërmarrjen e Lirë” Kukës, të cilët kanë dhënë një kontribut të vlefshëm për punën në terren me anketimet dhe takimet me grupet e synuara.

Një falenderim shkon për të gjitha gratë dhe vajzat e intervistuar, të cilat kanë bashkëpunuar gjatë intervistave dhe kanë marrë pjesë në takimet në grupe. Drejtueset e forumeve politike, forumeve rinore, drejtoresha të institucioneve lokale, këshilltare të Bashkisë Kukës, aktiviste të shoqërisë civile dhe biznesmene, të cilat treguan seriozitet dhe ndihmuan në finalizimin me sukses të këtij studimi, u jemi mirënjohës dhe shprehim vlerësimet tona.

Ky studim, është kontribut direkt i skuadrës së shoqatës “Rinia në Sipërmarrjen e Lirë”, të cilët kanë treguar një përkushtim të veçantë dhe kanë koordinuar në mënyrën më të mirë të mundshme mes njëri tjetrit për mbledhjen e të dhënave, përkthimit në gjuhën Angleze, reagimin dhe vlerësimin e punës së njëri-tjetrit, e cila kontriboi në finalizimin me sukses dhe cilësi të këtij studimi.

Njëkohësisht, nuk mund të harrojmë kontributet e të gjithë aktorëve vendor si; Bashki dhe Komuna apo institucionet e tjera në Kukës, të cilat janë gjendur në dispozicion për të ofruar të dhënat e nevojshme për këtë studim.

## LISTA E SHKURTIMEVE

ALB-AID	Association of Albanian Assistance for Integration and Democratic Development
CEDAW	The convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women.
ECHO	European Community Humanitarian Office
GTZ	German Organization for Technical Cooperation
INSTAT	Instituti i Statistikës
LSE	London School of Economic
MPCSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
NE	Ndihmë Ekonomike
OJF	Organizata Jofitimprurëse
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkpunim në Evropë
OSFA	Open Society Foundation for Albania
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
RSL	Shoqata “Rinia në Sipërmarrjen e Lirë”
UNICEF	The United Nations Children's Fund
UNDP	United Nation Development Programme
Un Women	Enti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Gruas

## **I. KAPITULLI I PARË: Përshkrim i përgjithshëm i Studimit**

### **I.I. Objektivat e studimit**

Ky studim ka për qëllim të sjellë në vëmendjen e aktorëve lokal; Qeverisje Vendore, Shoqërinë Civile, Media lokale dhe grupet komunitare sëbashku me të gjithë aktorët e tjerë të mundshëm problematikën dhe situatën reale sociale dhe ekonomike të grave në rrethin e Kukësit. Të dhënat e grumbulluara në terren përmes fokus grupeve, anketave, intervistave dhe gjetjet në studimet apo raportet e ndryshme, do të pasqyrohen duke sjellë me vete rekomandime të cilat mund të ndikojnë në përmirësimin e situatës social ekonomike për gratë në nivel lokal.

Objektivat e këtij studimi janë të lidhur ngushtë me ato të projektit “Përfshirje sociale përmes promovimit të barazisë gjinore dhe zbatimit të ligjit”, që Shoqata “Rinia në Sipërmarrjen e Lirë” Kukës ka zbatuar me mbështetjen e OSFA në Shqipëri.

Informim për gratë për ligjin e barazisë gjinore dhe antidiskriminimit; nxitje në përfshirjen e grave në debatin publik për çështjet e grave dhe vazhete të reja; vlerësim për situatën e përjashtimit social për gratë dhe të identifikimit të nevojave të grupeve e marginalizuara me qëllim pasqyrimin real të situatës dhe mundësitë për ndërhyrje në përmirësimin e gjendjes aktuale. Studimi në vetvete, pasqyron në mënyrë reale dhe të paanshme identifikimin e nevojave dhe përfshirjen e grave në jetën social ekonomike dhe rekomandimet për një analizë dhe ndërhyrje me qëllim përmirësimin e jetës dhe përfshirjes së grave në Kukës.

### **I.II. Metodologjia e studimit**

Gjatë këtij studimi janë kombinuar të dhënat nga burimet parësore anketimet, intervista gjysëm të strukturuar si dhe dy fokus grupe, ndërsa burimet dytësore janë statistikën dhe raportet që janë gjetur për rrethin e Kukësit. Të gjithë këto mjete të përdorura gjatë këtij studimi kanë lehtësuar dhe mundësuar mbledhjen e informacionit të besueshëm dhe pasqyrimin e situatës në Kukës.

Janë kryer 7 intervista gjysmë të strukturuar, të cilat u zhvilluan në periudhën Tetor – Nëntor 2011, zhvilluar me drejtues të forumeve politike, gazetarë, drejtues dhe aktivistë të shoqërisë civile, qeverisje lokale dhe administratë shtetërore në nivel lokal. Intervistat u zhvilluan nga asistenti i projektit në Bashkinë Kukës dhe Komunitat Shtiqen e Bicaj.

Studimi i burimeve dytësore. Gjatë punës kërkimore, jemi bazuar në raportet e fundit që kanë publikuar organizata ndërkombëtare, kryesisht mbi situatën social ekonomike të grave në Qarkun e Kukësit. Të dhëna janë marrë edhe nga INSTAT dhe burimet vendore të dala nga raportet e fundit, të disa OJF-ve vendore dhe njësitë vendore, Bashki/Komunë.

Gjatë këtij studimi janë realizuar 235 anketa nga të cilat 198 femra dhe 37 meshkuj, të pyetur kanë qenë qytetarë të territorit në Bashkinë Kukës, Komunitat Shtiqen dhe Bicaj. Kjo anketë kishte një pyetsor të strukturuar, i printuar dhe kryer në terren ballë për ballë me të anketuarit.

Fillimisht është kryer një anketë pilot, për të parë nëse kishte nevojë për ndryshime apo jo, më pas këto anketa janë realizuar nga anëtarë dhe bashkëpunëtorë të shoqatës RSL Kukës. Anketat në fillim janë miratuar nga drejtuesit e projektit.

Fokus grupet janë zhvilluar në territorin e Bashkisë Kukës. Takimi i parë është mbajtur në 7 Shtator 2011, me pjesmarrjen e grave dhe vajzave të moshave të ndryshme, pranë parkut të qytetit, në ambient të hapur, duke shfrytëzuar orarin dhe grumbullimin e grave të cilat dalin në kohë vere për shëtitje, ndërsa takimi i dytë është zhvilluar në datën 28 Shtator 2011, në sallën e mbledhjeve të RSL-së, me pjesmarrjen e 13 grave dhe vajzave të moshës 19 -30 vjeç.

### **I.III. Probleme dhe kufizime**

Gjatë këtij studimi janë shfaqur pengesa të cilat kanë ndikuar në realizimin në kohë të studimit dhe mungesë të dhënash. Një nga problemet ka qenë mungesa e interesit të grave për të marrë pjesë në fokus grupe, atyre grave të zgjedhura në forumet politike apo drejtueset e disa institucioneve lokale të cilat në të shumtën e rasteve nuk ishin të gatshme të pyeten apo të intervistohen. Mungesa e pjesmarrjes së grave nga zonat rurale në fokus grupet ka qenë gjithashtu e kufizuar dhe mund të ketë ndikuar në mbledhjen e të dhënave bazë dhe reflektimin e situatës apo problematikës që këto gra hasin në jetën e përditshme.

Ky studim gjithashtu ka hasur në vështirësi, në gjetjen e burimeve dytësore, sikurse janë raportet apo studimet për këtë zonë, me përjashtim të UNIFEM kur studime dhe raportet janë të plota dhe të verifikueshme.

Qarku i Kukësit paraqet vështirësi të shumta për vetë pozitën gjeografike dhe terrenin shumë të vështirë, karakterizuar nga infrastruktura e pazhvilluar, e cila krijon pengesa të mëdha për të punuar dhe për tu ndërlidhur mes fshatit dhe qytetit.. Qarku Kukës si edhe zona e marrë në studim, janë mjaft të shtrira në hapsirë dhe me probleme të shumta të identifikuara të zhvillimit social-ekonomik dhe të përfaqësimit politik. Të gjithë këta komponentë janë të ndërlidhur dhe formojnë një pengesë për tu kapërcyer. Për vetë specifikat e zonës, mundësive ekonomike, zhvillimeve të hershme të tranzicionit dhe të viteve të fundit, veçanërisht në zhvillimet gjinore, të të drejtave të grave, situatës dhe statusit të tyre, ky studimi, analiza dhe të kuptuarit e situatës bëhet edhe më e vështirë.

Mungesa e strukturave të organizuara sociale në shërbim të vet atyre, pamundësia e të qenit pjesë e tregut të punës, ekzistenca e politikave kombëtare të papërkthyer në ndërhyrje konkrete ka bërë që gratë të ndjehen të përjashtuara.

#### **I.IV. Përkufizimet e përdorura**

Gjatë këtij studimi janë trajtuar teorikisht disa terma në lidhje me përjashtimin dhe përfshirjen sociale, barazinë gjinore dhe përfaqësimin politik të grave. Këto përkufizime janë bazuar tek studiues dhe studime ndërkombëtare të kësaj fushe.

#### **I.V. Zona në studim**

Ky studim ka patur në fokus të tij rrethin e Kukësit, dhe përkatësisht Bashkinë Kukës, Komunitat Bicaj dhe Shtiqën. Këto njësi vendore janë përzgjedhur për shkak të numrit të popullsisë, mundësisë së aksesit të mbledhjes së informacionit dhe realizimit të anketave pasi komunitet e tjera janë zona të thella malore, me popullsi më të vogël dhe të karakterizuara nga vendbanime larg njëra tjetrës, çka do ta bënte të vështirë dhe të pamundur në disa raste, kryerjen e anketave dhe mbledhjen e informacionit<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Referojuni tabelës 2



## II. KAPITULLI I DYTË: Zhvillimi social dhe ekonomik

### II.I. Demografia dhe lëvizjet migratore

Lëvizjet demografike janë faktor ndikues por dhe pasojë e kushteve sociale dhe ekonomike të rajoneve ku janë karakteristikë. Kështu, fenomeni i shpërnguljes nga një zonë e caktuar në tjetrën dëshmon edhe për ekzistencën e problemeve sociale dhe në këto zona. Deri në vitin 2001 në rregjistrimin e parafundit të lëvizjeve demografike, të bëra nga INSTAT figuron se 36.5 përqind (92 300) e migrantëve të vendosur në Tiranë jetonin në prefekturën e Kukësit<sup>2</sup>. INSTAT thekson se i njëjti raport zhvendosjeje, mund të vazhdojë të jetë konstant deri në vitin 2021. Me rezultatet e para të marra nga Censusi 2011, tendenca vihet re të mos ketë ndryshuar që nga studimi i vitit 2001 për migrimin e brendshëm. Aktualisht nga Censusi 2011 figuron se popullsia e Kukësit ka vazhduar të zvogëlohet me 23 % gjatë dhjetëvjeçarit të fundit.

Migrimi i brendshëm në Shqipëri është qartësisht një migrim në një drejtim: rreth 91% e migrantëve ndër rajonale kanë lëvizur drejt qendrës dhe bregdetit. Sipas INSTAT Tirana përbën më shumë se gjysmën e zhvendosjeve me një numër të madh të zhvendosurish nga Kukësi dhe Dibra. Migrimi i lartë nga rajonet e veriut drejt qendrës, flasin për një shkallë të lartë të prapambetjes ekonomike të rajonit të veriut, ku investimet kanë qenë relativisht të kufizuara.

Nga Censusi i vitit 2011 rezulton se në dhjetëvjeçarin e fundit 2001-2011 vetëm qytete si Durrësi dhe Tirana janë përballur me një ngritje të vazhdueshme të popullsisë ndërkohë që të gjithë rrethet e tjera të Shqipërisë kanë pasur ulje, ku Kukësi vazhdon të qëndrojë në krye të listës së qyteteve me nivelin më të lartë të migrimit<sup>3</sup> megjithëse më të ulët se dhjetëvjeçarin e kaluar.

Aktualisht përmirësimi i infrastrukturës për Qarkun e Kukësit me ndërtimin e autostradës Durrës-Kukës që ka afruar shumë lidhjen e zonës verilindore me metropolin mund të sjellë ulje të kësaj tendence të migrimit të brendshëm nga zona e rrethit të Kukësit, situatë që vihet re edhe nga informacioni që shoqata RSL ka mbledhur me anë të fokus grupeve dhe mesa duket mbështetet dhe nga të dhënat e fundit të INSTAT dhe Census 2011 se ky fenomen është disi në rënie dhjetëvjeçarin e fundit.

Zona verilindore e Shqipërisë është klasifikuar ndër zonat më nivel më të lartë të varfërisë dhe papunësisë.<sup>4</sup> Zhvillimi ekonomik i rajonit nuk është faktori i vetëm i migrimit nga veriu drejt zonave të ulëta dhe qendrës. Faktorë të tjerë si strategjia e familjes, arsimi ose shëndetësia mund të luajnë gjithashtu, një rol në nivelin e migrimit të brendshëm. Në bashkinë Kukës ka një numër të madh familjesh që marrin ndihmë ekonomike: 2075 familje ose 33% e familjeve në qytet aktualisht marrin ndihmë ekonomike. Kjo shifër është ulur disi në krahasim më të dhënat e INSTAT të vitit 2000 ku numri i familjeve arrinte deri në 40% në Kukës.<sup>5</sup> Mosfunksionimi si duhet i politikave rajonale të punësimit bën që këto familje të qëndrojnë për një kohë mjaft të

<sup>2</sup> Parashikimi i INSTAT-it: Në vitin 2021, Tirana dhe Durrësi destinacione kryesore të migrimit të brendshëm

<sup>3</sup> Të dhëna të marra nga INSTAT

<sup>4</sup> Po aty

<sup>5</sup> Të dhëna të marra nga Bashkia Kukës dhe INSTAT

gjatë në këto skema. Prej familjeve që marrin ndihmë ekonomike, 150 prej tyre janë me kryefamiljare femra.

Migrantët nga verilindja drejt qendrës karakterizohen nga një strukturë e moshës së re: 68% e migrantëve janë nën moshën 12-39 vjeç, kundrejt 45 % të popullsisë së të gjithë vendit<sup>6</sup>. Nga Kukësi gjatë periudhës 1989-2001 janë larguar më tepër se 1/3 e popullsisë në drejtim të qendrës dhe bregdetit të vendit. Ndërkohë që emigracioni në vendet fqinje dhe më tej ka qenë karakteristike më tepër e anëtarëve meshkuj të familjes në një numër të madh gjatë këtyre dy dekadave. Ndërsa për gratë mund të vërejmë se ato kanë qenë më shumë të predispozuara të migrojnë brenda kufijve të Shqipërisë sesa jashtë tyre në ndryshim nga burrat. E njëjta tendencë e migrimit të grave është rregjistruar edhe nga Censusi 2011.<sup>7</sup> Lëvizjet e mëdha demografike, por sidomos emigacioni i meshkujve të familjes në vende të tjera, gjithashtu kanë ndikuar negativisht në situatën ekonomike për popullsinë e këtij qarku dhe në veçanti të gruas në zonën verilindore, për shkak të mundësive më të pakta të saj për punësim në sektorin shtetëror apo privat. Akoma më e vështirë paraqitet situata për gratë dhe vajzat e reja të cilat në sajë të mentalitetit konservator pasi martohen, zgjedhin të mbeten shtëpiake dhe të varura nga të ardhurat e kryefamiljarit. Në momentin që gratë nuk mund të përfitojnë më për shkaqe të ndryshme nga mbështetja ekonomike e kryefamiljarit, siguria e mjeteve të jetesës mund të përmbysset papritur në asnjë burim të ardhurash.

## **II.II. Situata ekonomike**

Të drejtat ekonomike të grave përfaqësohen me nivelin e pjesëmarrjes në forcat e punës, mbajtjen e vendit të punës dhe pagës. Në rajonin e Kukësit ka shumë faktorë që pengojnë zhvillimin e mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat e reja si dhe punësimin e tyre. Detyrimet e shumta ndaj familjes, rritjes së fëmijëve, mungesa e kualifikimit përkatës profesional, kurseve, aksesit i vogël ndaj pronës dhe pamundësia në këtë mënyrë për të marrë kredi për zhvillim biznesi privat, janë vetëm disa prej pengesave që hasen nga gratë.

Situata ekonomike e grave në qytetin e Kukësit, rezultojnë e vështirë për shkak të nivelit më të lartë të papunësisë në krahasim me meshkujt, një gjë e tillë figuron edhe nga anketimi i bërë së fundmi nga shoqata RSL. Mes meshkujve dhe femrave të anketuar në fshat dhe në qytet me një moshë mesatare 40-59 vjeç, të anketuarit meshkuj janë të punësuar në masën 45.95%, ndërkohë që situata paraqitet e kundërt mes të anketuarve femra, ku pjesa më e madhe e tyre, janë të papuna në masën 43.43%. Mes grupeve të meshkujve dhe femrave të anketuara, rezultojnë se perceptimi i shkaqeve të prapambetjes së zhvillimit dhe fuqizimit të grave është pasojë e mentalitetit tradicional dhe mungesës së mbështetjes nga familja. Pjesa më e madhe e të intervistuarve meshkuj dhe femra, mendojnë se gratë janë pak ose aspak të pavarura ekonomikisht.

---

<sup>6</sup>Migracioni në Shqipëri-Rregjistrimi i Popullsisë dhe i banesave INSTAT 2001 fq 5

<sup>7</sup> Shih <http://census.al/> [ vizituar në datë 10/01/12]

Nga anketimi, gjithashtu rezulton se mundësitë për mbështetje të grave që duan të hapin biznes apo të merren me aktivitete politike janë të vogla, për shkak të situatës së tyre ekonomike dhe mungesës së pavarësisë. Situata ekonomike paraqitet akoma më e vështirë për familjet me kryefamiljare femra, që për arsye emigrimi të meshkujve apo shkaqë të tjera janë të detyruara të marrin përsipër të gjithë peshën e mbajtjes së familjes. Për shkak të mentalitetit konservator që vihet re si në qytet edhe në fshat, të mundësive të pakta për punësim të grave që nuk kanë arsim të lartë, apo atyre të cilat bëjnë një jetë shtëpiake, në të shumten e rasteve burimi i vetëm i të ardhurave mbetet ndihma ekonomike nga bashkia/komuna apo ndihma nga të afërmit.

Në rajonin e Kukësit, janë ruajtur edhe në ditët e sotme strukturat tradicionale shoqërore të cilat nuk i krijojnë shumë hapësira angazhimit të gruas në biznes dhe vendimmarrje, fuqizimit të saj ekonomik apo angazhimit të pavarur. Niveli i lartë i emigrimit sidomos i meshkujve të aftë për punë dhe struktura e vjetër familjare me marrëdhënie patriarkale, kanë rritur angazhimet e gruas në sferën private dhe familjare duke nxjerrë jashtë sferës së interesit aktivitetet që kërkojnë një angazhim më të madh të gruas, në një fushë tjetër si ajo politike apo e biznesit. Struktura patriarkale e familjeve, vazhdon të bëjë burrin përgjegjës kryesor për mbajtjen e saj, qoftë edhe në kushtet e emigrimit jashtë kufijve, prandaj edhe të ardhurat kryesore të familjes shpesh vijnë dhe nga remitancat. Pyetjes: A mendoni se sigurimi i të ardhurave financiare për fëmijët tuaj është detyrim edhe i gruas? 94.59% e meshkujve dhe 98.99% e femrave të intervistuar i janë përgjigjur me Po, ndërkohë që nga vëzhgimet e tjera në terren rezulton një realitet krejt tjetër për pozitën reale të gruas.

Vëzhgime të jetës së përditshme tregojnë se pjesëmarrja e grave dhe vajzave në vendimmarrje është gjithashtu e lidhur me aksesin ndaj pronës e të ardhurave, nivelin arsimor të tyre, vendbanimin dhe moshën. Për ëështje brenda familjes, kur vendimmarrja lidhet me shpenzimin e parave, për numrin e fëmijëve, arsimimin e tyre, migrimin ose emigrimin e familjes apo të një anëtari të saj ato merren kryesisht nga kryefamiljari.<sup>8</sup>

Përsa i përket pjesëmarrjes së gruas në politikë, nga bisedat e realizuara me dy fokus grupet nga shoqata RSL, u vu re se koha e vetme kur vëmendja politike kthehej nga gratë ishte gjatë periudhave zgjedhore. Madje, gratë konkluduan se edhe në këto raste angazhimi i tyre në politike ishte i pakët. Arsyeja kryesore duket të jetë fakti se partitë politike akoma nuk janë ndërgjegjësuar për rëndësinë e pranisë së gruas në strukturat politike. Kjo edhe për shkak se partitë politike nuk ndjehen të “kërcënuara” se mos humbasin votat e grave, në rast se nuk përfshijnë mjaft prej tyre në strukturat politike. Përkundrazi duket sikur akoma votuesi shqipëtar, voton jo vetëm për subjektin politik dhe jo për kandidatin, por gjithashtu në Shqipëri politika vazhdon të cilësohet si “punë burrash”<sup>9</sup> gjë që bën edhe gratë vetë të dyshojnë në aftësitë e tyre politike dhe gjithashtu të hezitojnë të mbështesin një kandidatë grua më tepër se një kandidat burrë në raste zgjedhjesh. Kjo situatë, duket sikur nuk është korrigjuar edhe pas miratimit të kuotave zgjedhore prej 30% në zgjedhjet lokale<sup>10</sup>, ku si sanksion për partitë politike që nuk përfshijnë në 30% të listës së tyre kandidatë femra të renditur në mënyrë të alternuar me

<sup>8</sup> Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje (2007-2010) MPCSSHB

<sup>9</sup> Albanian Elections Survey 2008- UNIFEM

<sup>10</sup> Ndryshimet në Kodin Zgjedhor (Miratuar me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008)

kandidatët meshkuj, duhet të paguajnë një gjobë prej 30,000 Lekë. Ky lloj sanksioni ka rezultuar joefektiv në zbatimin e ligjit nga partitë politike në nivel lokal për shkak të shumës simbolike, por edhe mosekzekutimit të sanksionit nga organet përkatëse. Kjo është edhe një nga arsyet për një mungesë të madhe të përfaqësimit të gruas në nivel lokal edhe pas ndryshimeve ligjore.

Vëmendja e strukturave shtetërore lokale ndaj këtyre problemeve ka qenë shumë e vogël ose ka munguar plotësisht. Informacioni ndërmjet banorëve, sidomos në zonat rurale, ka munguar tërësisht sipas të dhënave të përfutur nga anketa. Perceptimi qytetar për përfshirjen e grave në aktivitete biznesi apo politike, është gjithashtu shumë i ulët mes meshkujve dhe mes femrave vetë. Në zonat rurale angazhimi politik apo në fushën e biznesit të grave duket diçka jo shumë e zakonshme, ku në kushtet e vështirësive ekonomike, çështjet e barazisë gjinore duket të jenë mënjanuar totalisht nga vëmendja e banorëve.

### **II.III. Tregu i Punës**

Qarku i Kukësit është mjaft i prekur nga probleme që kanë të bëjnë me migrimin e të rinjve, nëpunësimin dhe punën informale në sektorin e bujqësisë, mungesën e trajnimeve dhe të shërbimeve për rritjen e produktivitetit, si dhe me mungesën e kushteve të sigurisë dhe shëndetit në punë.<sup>11</sup>

Kriza ekonomike e vendeve fqinje (kryesisht Greqisë) gjatë vitit 2010-2011 ka shtuar fluksin e emigrantëve të kthyer në Kukës, të cilët i shtohen grupit të të papunëve. Përsa i përket punësimin të grave, mundësia dhe koha që kalojnë ato në pritje të një mundësie të re për punësim duket të jetë më e gjatë se në rastin e burrave. Gjithashtu vihet re një disproporcion shpërndarjeje të të punësuarve femra mes sektorëve publikë dhe bizneseve private. Numri i grave që janë angazhuar në biznese të vogla private mbetet shumë i vogël në krahasim me meshkujt pavarësisht se niveli i papunësisë tek gratë është më i theksuar se te meshkujt në zonën e Kukësit. Gratë janë të përballura me një nivel më të lartë papunësie, por pavarësisht kësaj, ato janë më pak në kërkim të një pune sesa meshkujt, kështu që ato nuk përbëjnë një forcë aktive në tregun e punës.

Në zonat rurale, gratë janë të angazhuara pjesën më të madhe të kohës në aktivitetet bujqësore dhe familjare. Sipas anketimit, papunësia në fshat është në nivelin 52% ndërsa në qytet në një raport prej 37%. Mes meshkujve të intervistuar 45.95% e tyre janë të punësuar. Ndërkohë që situata përmbysset në rastin e grupit të grave të intervistuar me 43.43% të papuna në fshat dhe qytet. Shkalla më e lartë e papunësisë është në fshat ku përgjithësisht ekziston vetëm mundësia e punësimin bujqësor familjar. Në qytet, niveli i papunësisë është mjaft shqetësues ku punësimi më i madh i grave vërehet në administratën shtetërore e më pak në biznese private. Kjo situatë mund të çojë në diskriminimin dhe përjashtimin social të grave.

Në nivel bashkiak, figuron se numri i bizneseve që paguajnë taksa bashkiake është 307 ndërkohë që prej tyre vetëm 3.3% ose 10 biznese drejtohen nga femra<sup>12</sup>.

<sup>11</sup> Faqja Zyrtare e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta [vizituar 19/01/12]

<sup>12</sup> Të dhëna të marra nga Bashkia Kukës për vitin 2011

Sipas rezultateve të anketimit, grave u mungon mbështetja e familjes dhe sidomos e bashkëshortëve për të nisur një aktivitet biznesi apo një sipërmarrje. Mes të anketuarve gra, pjesa më e madhe prej 62.86% nuk disponon asnjë lloj aktiviteti privat. Gjithashtu pjesa më e madhe e aktiviteve ekzistuese janë të drejtuara nga meshkujt e familjes. Sipas perceptimit të të anketuarve meshkuj, raporti mes meshkujve dhe femrave që drejtojnë biznese është në vlerat 40.54% meshkuj dhe 8.11% femra.

Shqetësimi tjetër në lidhje me situatën e tregut të punës përqëndrohet në efektet e rritjes së punësimit informal dhe niveleve të larta të migracionit brenda vendit. Në nivel kombëtar sipas INSTAT struktura e punësimit tregon që ekonomia është ende e dominuar nga bujqësia dhe aktivite të tjera tradicionale. Sektori “modern” i punësimit është shumë i vogël. Pothuajse 60% e totalit të punësimit është ende në bujqësi<sup>13</sup> ku prodhimi është në shkallë të vogël dhe siç përmendet më lart është tipikisht i organizuar rreth njësisë shtëpiake. Të gjitha këto kushte janë disfavorizuese për pozitën e gruas dhe mundësinë e saj për të ndryshuar diçka. Numri i lartë i të punësuarve informal kryesisht në sektorin privat bëhet shkak për shkeljen e të drejtave të punonjësve dhe pranimin e vendit të punës kundrejt një pagese më të ulët.

Kushtet e tregut të punës janë në veçanti të pafavorshme për gratë, duke krijuar situata për diskriminim dhe barriera strukturore ndaj punësimit të tyre. Gratë kanë nivele të ulta pjesëmarrjeje në shoqëri dhe nivele shumë të larta papunësie. Në nivel kombëtar mesatarisht, pagat për femrat janë 35% më të ulta sesa ato për meshkujt, duke patur parasysh këtu edhe moshën, arsimimin dhe karakteristika të tjera personale<sup>14</sup>.

Programet e nxitjes së punësimit fokusohen në ndërhyrje në shkallë të vogël të cilat subvencionojnë punësimin dhe mbështesin trajnimin e punëtorëve të papunë. Burimet e akorduara për këto programe janë shumë të vogla dhe kanë ardhur në rënie qysh nga viti 2000 në nivel kombëtar, ndërkohë që zona verilindore ka qenë tradicionalisht akoma më larg vëmendjes së planeve qeveritare.

Problematikë kryesore mbetet çështja e hapjes së vendeve të reja të punës në rajon e sidomos në sektorin formal të punësimit. Kjo situatë e zgjatur në rajonin verilindor ka krijuar nivele të larta informaliteti, e cila është pasuar me fenomene të tjera negative si përjashtimin nga tregu i punës i grupeve të caktuara shoqërore e sidomos të grave, dhe mungesë të mbrojtjes sociale të tyre. Gratë të cilat janë pjesë e krahut të punës e kanë më të vështirë të gjejnë një punë dhe nëse e humbasin atë mbeten në situatën e një papunësie për një kohë më të gjatë se meshkujt. Të dhënat mbi papunësinë sugjerojnë që ka një nivel të lartë shkurajimi midis grave në tregun e punës në nivel kombëtar dhe rajonal. Shkurajimi është gjithashtu evident tek të dhënat mbi papunësinë afatgjatë në nivel kombëtar; në vitin 2004, 72% e grave të papuna kishin qenë të papuna për së paku një vit, në krahasim me 65% që ishte kjo shifër për burrat.<sup>15</sup>

Shkaqet për mungesën së angazhimit ekonomik të gruas janë njëlloj të perceptuara si ndërmjet grave dhe burrave të anketuar, si në fshat dhe qytet. Shumica e të intervistuarve mendojnë se pavarësia ekonomike e grave është e pakët ose mungon tërësisht. Të intervistuarit në qytet

<sup>13</sup> Studim i Bankës Botërore “Shqipëria-Një vlerësim i Tregut të punës” (Maj 2006) fq v

<sup>14</sup> Po aty fq v

<sup>15</sup> Po aty fq 83

mendojnë se mjaft shpesh është diskutuar për çështjet e fuqizimit të gruas, ndërkohë në fshat ky perceptim është mjaft i ulët dhe këto çështje rrallë herë janë bërë objekt diskutimi nga strukturat përkatëse apo vetë komuniteti.

Në fshat të anketuarit janë treguar me skeptikë në lidhje me mbështetjen e gruas për ngritjen e një biznesi apo pjesëmarrjen në aktivitete politike. Në fshat dhe në qytet të anketuarit në pjesën më të madhe mendojnë se gratë nuk janë të lira të angazhohen në politikë e as në biznes, ndërkohë që në qytet dy grupet e ndara në mendime janë përafërsisht të barabartë në numër. E thënë ndryshe në qytet ekziston dhe një pjesë e qytetarëve edhe pse në një numër pak më të vogël që dëshmon (sipas përvojës së tyre personale) se femrave nuk u mungon pavarësia ekonomike. Ndërsa në fshat grupi që mendon se gratë kanë një nivel të caktuar pavarësie ekonomike janë në minorancë.

#### **II.IV. Mirëqenia Sociale dhe Mbrojtja Shoqërore**

Megjithëse nuk ka të dhëna zyrtare të kohëve të fundit për nivelin e varfërisë në rajon, studime të bëra nga organizata të huaja tregojnë për shifra mjaft të larta të saj. Sipas një studimi të realizuar nga UNICEF (2000) dekadën e kaluar në rajonin e Kukësit, mesatarisht mbi 45 përqind e popullsisë jetonte nën nivelin e varfërisë, dhe përballonte pjesën më të madhe të shpenzimeve të jetesës me të ardhurat nga ndihma ekonomike<sup>16</sup>. Në disa komuna të thella të rrethit të Kukësit më shumë se 60% e popullsisë kanë të ardhura kryesore ndihmën ekonomike. Të tilla janë komunat Bushtrice, Surroj, Grykë e Çajës, Topojë e Fierze.

Sipas të dhënave lokale, rrethi i Kukësit numëron 60521 banorë shifër që përfshin fshatrat dhe qytetin. Pavarësisht se popullsia urbane ka pësuar rritje dekadën e fundit, ajo mbetet më e vogël se ajo rurale në përqindje. Në vitin 2001 raporti ishte 35.8% me 64.2% popullsi urbane me atë rurale, ndërsa ky raport ka pësuar një luhatje në favor të urbanizimit në dekadën e fundit me një nivel 61% me 39% përkatësisht popullsi rurale dhe urbane.<sup>17</sup> Ky proces ndryshimi ka ndodhur me hapa shumë të ngadaltë dhe kjo është edhe një prej shkaktarëve të situatës aktuale si informaliteti në punësim dhe mundësi të vogla për zhvillim industrial dhe hapjes së vendeve të reja të punës, sidomos për gratë dhe vajzat e reja. Në të tilla kushte dhe mbrojtja sociale e shtresave më në nevojë, si të grave dhe familjeve të varfëra, nuk arrihet në nivelin e duhur për shkak të mungesës së të dhënave që pasqyrojnë situatën reale mbi këto fenomene.

#### **II.V. Arsimit**

Ndikimi i arsimit në përballjen dhe zgjidhjen e problemeve të barazisë gjinore është me rëndësi mjaft të madhe. Ai mbetet një nga mjetet e rëndësishme që ka në dorë shoqëria moderne si

<sup>16</sup> Vlerësim i situatës sociale dhe ekonomike në rajonet e Shqipërisë-UNICEF (Dhjetor 2000)

<sup>17</sup> Rregjistrimi i popullsisë dhe i banesave INSTAT 2010

instrument ndërgjegjësimi për të gjithë shoqërinë e cila krijon barazi gjinore të vërtetë, duke shmangur dallimin, diskriminimin dhe abuzimin gjinor, duke respektuar të drejtën e gruas për të patur shanse dhe mundësi të barabarta.

Sektori i arsimit, në pamje të parë, të jep përshtypjen se është ai me një numër më të madh të grave të punësuar, përfshirë ciklin e ulët dhe të lartë, shkollat fillore, tetëvjeçare dhe të mesme si dhe ruan raporte gjinore në punësimin e stafit arsimor. Megjithatë, në përballjen me statistikat, vihet re edhe këtu një mungesë barazie e përfaqësimit gjinor, dhe sidomos në përfaqësimin e grave në postet drejtuese të institucioneve arsimore.

Në ciklin 9-vjeçar figuron se stafi pedagogjik është gjithashtu i pabalancuar në konceptin gjinor, kështu deri në vitin 2011 në rrethin e Kukësit (përfshirë shkollat në qytet dhe fshatra) raporti i stafit akademik është 596 meshkuj dhe 359 gra. Prej këtyre në poste drejtuese, në shkallë rrethi, 46 janë meshkuj dhe 19 gra në shkallë rrethi. Gjithashtu në nivelin e arsimit të mesëm, rezulton i njëjti raport pabarazie përse i përket stafit të punësuar. Prej tyre, 135 janë meshkuj dhe 72 janë gra, ndërkohë që në poste drejtuese, gratë, në nivelin e arsimit të mesëm janë akoma më pak në numër, në një raport 5 me 15 ose 1 femër drejtuese për çdo 3 drejtues meshkuj<sup>18</sup>. *Nga statistikat vihet re se me rritjen e rëndësisë dhe përgjegjësisë së posteve drejtuesve, zvogëlohet dhe numri i femrave të punësuar për këto funksione.*

Për shkak të riorganizimit të jetës shoqërore mbi principet e lirisë personale dhe ekonomisë së tregut, fenomeni i braktisjes së shkollës, i uljes së cilësisë së arsimit ndihet sidomos në fshat, veçanërisht në zonat e thella malore. Të dhënat për braktisjen me bazë gjinore, nuk ka.

Përse i përket nivelit arsimor të banorëve të rrethit të Kukësit, nuk ekzistojnë për këtë të dhëna të sakta. Gjithsesi, faktorë të tillë si përqëndrimi i numrit më të madh të banorëve akoma në zonat rurale kundrejt atyre urbane, luan një rol pengues në rritjen e nivelit arsimor, sidomos të grave dhe vajzave të reja, kur janë të njohura vështirësitë e tyre të shumta për të vazhduar studimet larg vendbanimit të tyre.

Nga anketimi rezulton se arsimi mesatar në zonat e anketuara (qytet dhe fshat), është arsimi i mesëm si mes meshkujve dhe femrave të anketuara. Ndërkohë që vihet re një ndryshim mes të anketuarve meshkuj dhe femra. Ndërmjet meshkujve grupi i dytë më i madh i të intervistuarve është me arsim të lartë<sup>19</sup>. Kurse kjo tendencë nuk vihet re mes femrave pasi grupi i dytë më i madh mes tyre është me arsim tetëvjeçar. Pavarësisht nga të dhënat e anketës nga rregjistrimet e studentëve në degët e Ekonomisë, Infermierisë dhe Gjuhës së Huaj të hapur në qytetin e Kukësit, numri i studenteve femra duket të jetë më i madh se ai i meshkujve. Kjo mund të jetë për arsye të ndryshme si afërsia gjeografike e universitetit e cila krijon më shumë lehtësira studimi sesa universitetet në kryeqytet apo qytete të tjera. Gjithashtu rritja e raportit të banorëve qytet/fshat mund të jetë edhe një faktor tjetër pozitiv në pasjen e një numri më të madh vajzash të regjistruara.

<sup>18</sup> Të dhënat janë marrë nga DR Arsimore, Zyra e Statistikave, Kukës

<sup>19</sup> Numri i të intervistuarve meshkuj është I vogël, prandaj dhe përfundimi nuk është gjithpërfshirës

## **II.VI. Shëndetësia**

Nga një studim i realizuar nga MPCSSHB në nivel kombëtar, rezulton se njohuritë e grave për çështjet e shëndetit riprodhues dhe të planifikimit familjar janë në zgjerim të vazhdueshëm, sidomos falë mediave elektronike dhe të shkruara. Në rajonin e Kukësit, pavarësisht nga situata jo e favorshme ekonomike, lindshmëria vazhdon të mbetet e lartë në krahasim me rajonet e tjera të Shqipërisë, ndërkohë që raporti kombëtar është një fëmijë 0-4 vjeç për çdo 5 gra në moshën e riprodhimit ( 15-49) vjeç, në Kukës kjo arrinte deri në një fëmijë për çdo dy gra sipas studimit të bërë nga INSTAT.<sup>20</sup> Megjithëse mungojnë të dhëna të fundit, ato besohet të luhaten në të njëjtat nivele edhe pas një dekade, pasi faktorët ndikues në këtë fenomen nuk kanë pësuar shumë ndryshim, si urbanizimi, niveli i informacionit, mentaliteti konservator etj. Në këtë kontekst duhet vlerësuar edhe niveli i ulët i njohurive dhe edukimit seksual që realizohet në shkolla, roli i të cilëve duhet të jetë parësor për krijimin e një kulture dhe edukimi seksual sa më të gjërë duke ndikuar drejtpërdrejt mbi gratë dhe vajzat dhe në mënyrë të tërthortë mbi meshkujt e rinj, për nevojën universale të një komponenti të tillë kulturor dhe jetik siç është kultura, edukata dhe standartet e higjienës specifike.

Numri i madh i lindjeve është në kontrast me mundësitë e pakta për gjenerimin e të ardhurave nga punësimi apo punët bujqësore të banorëve të këtij rajoni. Pavarësisht nga kjo, ky tipar dëshmon për një dominancë të modelit tradicional të familjes me shumë fëmijë akoma ndikuese në rendin social.

Gjithashtu arsyeja kryesore e aborteve është e ndikuar nga mungesa e informacionit mbi planifikimin familjar karakteristike kjo sidomos për zonat rurale të rrethit dhe pamundësia e tyre për të mbështetur ekonomikisht familje të mëdha e me shumë fëmijë.

## **II.VII. Politikat institucionale dhe projekte në fushën e barazisë gjinore**

Ndihma ndaj grave për të qenë të barabarta në shoqëri, është e lidhur me disa specifika gjinore të natyrshme dhe role stereotipike të konsoliduara padrejtësisht nga shoqëria si detyrime taksative të saj në familje. Përsa i përket politikave rajonale shtetërore për barazinë gjinore dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive të gruas, ato mungojnë pothuajse plotësisht, dhe në rast të kundërt niveli i informimit të qytetarëve për këto nisma apo politika, është shumë i ulët, faktor që vendos në pikëpyetje shpesh rezultatet e tyre dhe impaktin në komunitet.

Në nivel lokal, sipas informacionit të marrë nga zyra rajonale e punës<sup>21</sup> ekziston një iniciativë e UNDP-Kukës e përfaqësuar edhe në nivel bashkiak për rritjen e pjesëmarrjes së gruas në vendimarrje dhe politikë. Ndërkohë pranë Zyrës së Punës ka pasur një iniciativë për nxitjen e biznesit mes grave të Prefekturës së Kukësit (Kukës, Has, Tropojë) ku 11 gra të përzgjedhura për ngritje biznesi u trajnuan dhe më pas 2 prej atyre ishin të afta të përfitonin një fond prej 2000

<sup>20</sup> Migracioni në Shqipëri-Rregjistrimi i Popullsisë dhe i banesave INSTAT 2001, fq 44

<sup>21</sup> Intervistë me zj. M. Hoxha, Drejtoreshë e Zyrës Rajonale të Inspektoriatit të Punësimit-Kukës



USD për ngritjen e një biznesi. Gjithashtu një tjetër organizatë e huaj, GTZ, ka ofruar fonde për rimëkëmbjen e biznesit të ngritur nga gratë. Në sajë të këtij projekti janë sponsorizuar 2 gra (nga Hasi dhe Kukësi) me një fond prej 2500 USD secila në fushën e prodhimeve artizanale.

Si punëkërkuese femrat janë më pak të regjistruara në Zyrën e Punës në krahasim me meshkujt dhe për këtë arsye është e vështirë dhe zgjidhja e problemit të papunësisë ndërmjet grave dhe vajzave.

Projekte dhe përpjekje ka patur në mënyrë të vazhdueshme në rajon në adresimin e barazisë gjinore nga aktorë të ndryshëm. Ndryshimi i madh, është intensiteti dhe numri i projekteve në kohë të ndryshme. Në kohë fushatash zgjedhore rritet numri i projekteve dhe iniciativave, dhe pas tyre ky numër bie. Pavarësisht rezultateve pozitive të këtyre përpjekjeve, vazhdimësia nuk është e garantuar dhe në shumë raste, rezultatet e arritura nuk japin impaktin e duhur.

Në Kukës, projekte në fushën e barazisë gjinore janë zbatuar nga organizma Ndërkombëtare, Kombëtarë dhe OJF lokale të profilizuara në këtë fushë.

OSBE ka një program të veçantë të mbështetjes së grave, ashtu siç ka UN WOMEN, UNDP, OSFA, OPIC etj. Këto programe dhe iniciativa kërkojnë vazhdimisht angazhimin dhe partneritetin e aktorëve lokalë si të institucioneve shtetërore ashtu edhe OJF-ve.

Ndër aktorët kryesorë lokalë janë forumet politike të grave, OJF-të si WCCS, RSL<sup>22</sup>, ALB-AID, Gruaja në Zhvillim etj, të cilat në partneritet me institucionet dhe me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm, kanë kontribuar në përmirësimin e situatës, rritjen e përfaqësimit gjinor dhe vendosjen e prioriteteve të qarta për të ardhmen.

## **II.VIII. OJF-të dhe Media**

Barazia gjinore dhe diskriminimi janë terma relativisht të reja në shoqërinë shqiptare pavarësisht se diskriminimi i grave në sektorë të ndryshëm të jetës ka qenë gjithmonë i pranishëm. Një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin e shoqërisë për këto probleme sociale luajnë media dhe shoqëria civile, sidomos në promovimin e figurës së gruas në politikë.

### ***Shoqëria civile dhe karakteristikat e saj në Kukës***

Prejardhja nga një sistem ku puna vullnetare, ndihma reciproke, solidariteti ishin keqpërdorur në funksion të pushtetit, bën që besimi i qytetarëve të jetë problematik dhe kontributi i përbashkët në shoqërinë civile dhe strukturave të tjera të organizuara të jetë i vogël. Kjo duket si një tipar sidomos i komuniteteve të varfra dhe kategorive me më pak mbështetje. Mospjesëmarrja e qytetarëve në jetën publike sot, apo mungesa e dëshirës për solidaritet dhe punë vullnetare e ka burimin tek e kaluara. A. Krasniqi, trajton këtë situatë duke u shprehur se “Kjo trashëgimi negative e së kaluarës bashkë me faktorë të tjerë më pak të rëndësishëm ndikuan në uljen e dukshme të nivelit të motivimit dhe angazhimit qytetar” (Krasniqi, 2004, f.36). Organizatat e shoqërisë civile, të cilat e bazojnë një pjesë të punës te vullnetarizmi i mbështetësve të tyre, morën një goditje që në fillim.

<sup>22</sup> RSL është e angazhuar në fushën e barazisë gjinore me një kontribut të qartë ndër vite.

Me ndryshimet demokratike, nevoja për shoqëri civile doli në pah si një domosdoshmëri për strukturën sociale të krijuar, duke u konsideruar në fillimet e veta si kundërshtare e politikave të çdo qeverie si dhe ofruese alternativash dhe idesh të reja. Në vitet e para të tranzicionit, organizatat e para kombëtare hapën degët e tyre edhe në Kukës<sup>23</sup>.

Fillesat e një shoqërie civile të konsoliduar në Kukës, duhet ti kërkojmë pas vitin 1999, kohë kjo që përkon më luftën e Kosovës dhe shpërnguljen masive të qytetarëve të saj. Eksodi i vitit 1999, solli në Kukës shumë organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare, të cilat ndihmuan në procese të ndryshme të menaxhimit të krizës.

Qëndrimi i këtyre organizatave në Kukës, zgjati përtej kthimit të kosovarëve në shtëpitë e tyre. Intelektualë me profile të ndryshme të punësuar në këto organizata, gjatë kësaj periudhe mësuan mënyrën e funksionimit të organizatave joqeveritare dhe hodhën bazat për ngritjen e atyre lokale në Kukës.

Në vitin 2001, me mbështetjen e CARE International me financim të ECHO, u zbatua një projekt për zhvillimin e qendrave komunitare me komponentë: dhënia e granteve të vogla për mbështetjen e shërbimeve sociale të OJQ-ve dhe training i drejtuesve të tyre (CARE, 2001, f. 7). Nga ky projekt përfituan një grup i vogël intelektualësh të cilët kishin ide dhe morën pjesë në trainime nga CARE International, më pas përfituan nga grantet e vogla për të zhvilluar mini projekte për grupet e interesit që ata përfaqësonin. Kështu që lindën organizatat e para me fokus barazinë gjinore.

UNDP, gjatë viteve 2002-2008<sup>24</sup> si pjesë të programit të vet kishte edhe ngritjen e organizatave më bazë komunitare bazuar në vullnetarizmin e individëve me qëllim mbrojtjen e interesave të tyre si dhe propozimin e prioriteteve të zhvillimit për secilin komunitet. Kjo iniciativë ishte e shtrirë edhe në zonat rurale. Gjithashtu, u ngritën edhe disa organizata me bazë komunitare për gratë. Pavarësisht funksionimit gjatë periudhës së projektit, duket se vazhdimësia e këtyre iniciativave nuk ishte e garantuar. Këto organizata nuk arritën të sigurojnë vazhdimësi të aktiviteteve dhe të kthehen në aktorë në komunitetin e tyre.

Për qëllimin e studimit është e rëndësishme të përcaktohet se sa organizata janë dhe sa janë funksionale dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në Kukës. Për këtë çështje nuk ekziston një shifër e saktë, meqenëse regjistrimi i tyre bëhet në Gjykatën e Tiranës sipas ligjit shqiptar për OJF-të, megjithatë sipas Zyrës së Shërbimeve Sociale në Kukës, ekzistojnë rreth 50 OJF të ndryshme lokale. Nga këto vetëm tre janë të rregjistruara pranë Drejtorisë Rajonale të Tatim Taksave dhe paguajnë detyrimet financiare në mënyrë të rregullt, ndërsa 3-4 OJF të tjera janë sezonale<sup>25</sup> të lidhura me fushatat zgjedhore apo fushata tematike të tjera. Pjesa tjetër janë pothuajse inaktive dhe nuk përfaqësojnë asnjë grup shoqëror.

Kur flasim për shoqërinë civile në Kukës, duhet të pranojmë se mungojnë kapacitetet për të krijuar një rrjet të fortë organizatash, pavarësisht se mund të identifikojmë individë të fortë. Për të luajtur një rol të rëndësishëm në demokratizimin e jetës në shërbim të përmirësimit të kapitalit social, forcimit të lidhjeve brenda komuniteteve dhe grupeve të targetuara dhe si qëllim edhe të

<sup>23</sup> Shoqata për Kulturë Demokratike, Komiteti i Helsinkut etj

<sup>24</sup> Gjatë kësaj periudhe u ngritën mbi 50 organizata jo-fitimprurëse

<sup>25</sup> Të dhëna të marra nga Drejtorja e Tatimeve Kukës (Prill 2011)

studimit tonë të prodhojë organizata dhe grupime të forta në mbështetje të iniciativave gjinore, duket se është e vështirë.

Në Kukës operojnë dy apo tre organizata të grave, në varësi të projekteve dhe mbështetjes që ato përfitojnë në kohë të ndryshme. Varësia nga burimet financiare të jashtme, mungesa e vizionit dhe strategjisë së zhvillimit të tyre si dhe operimi me një staf të ngushtë bën që vetë ekzistenca e tyre të vihet shpesh në dyshim.

### *Media*

Në rajonin e Kukësit funksionojnë një televizion dhe një radio lokale. Roli i tyre është gjithashtu modest për shkak të arsyeve kryesisht financiare. E para me histori 51 vjeçare të transmetimit dhe e dyta me 14 vite pune. Në stafin e punësuar në to, janë 3 femra dhe 5 meshkuj gazetarë, kurse raporti femra meshkuj në administratë është disi më i balancuar. Ndërsa në nivel qarku, mund të përmendet edhe një televizion lokal në Bajram Curri por që nuk transmeton programacion të plotë. Në Kukës mungojnë gazetat dhe revistat lokale, gjithsesi ekzistojnë korrespondentë të mediave kryesore kombëtare që raportojnë për çdo ngjarje në rajon. Programacioni mbetet në nivele të natyrës argëtuese dhe raportuese pa iniciativa të mirëfillta ndërgjegjësuere të temave sociale, kjo edhe për mungesë të njohurive mbi çështjet gjinore të stafit përkatës, por edhe për shkak se barazia gjinore ka qenë pjesën më të madhe të kohës e lënë në hije nga vëmendja e çdo autoriteti shtetëror qëndror apo lokal.

I njëjti fenomen vihet re jo vetëm në nivel lokal por dhe kombëtar, që vjen ndoshta dhe nga fakti se shumica e mediave vizuale janë private, në pjesën më të madhe të tyre dhe mundësitë e financimit janë shpesh ato që orientojnë dhe programacionin. Programacione që i shërbejnë edukimit të audiencës në lidhje me çështjet e barazisë gjinore kanë qenë prezente në televizion zakonisht në formën e tryezave të rrumbullakta dhe bisedave direkte vetëm në rastin kur kanë qenë pjesë e aktiviteteve të shoqatave lokale. Nga intervista me punonjës të televizionit<sup>26</sup> lokal, rezulton se çështjet e barazisë gjinore dhe diskriminimit të gruas paraqesin vështirësi në trajtim e sidomos në marrjen e informacionit në nivel lokal, kjo për shkak të mentalitetit në rajon, të karakterit disi të mbuluar të këtij fenomeni që nuk lejon shumë mundësi për interpretim të të dhënave dhe nxjerrjes së konkluzioneve konkrete.

Nga vëzhgime të realizuara në shkallë vendi, duket sikur për problemet dhe shqetësimet që kanë gratë në çështjet ekonomike, në angazhimin politik dhe shqetësimet arsimore, roli i medias në Kukës nuk është në të njëjtin nivel me atë kombëtar.<sup>27</sup>

Në nivel kombëtar por edhe lokal, mediat duket sikur angazhohen shumicën më të madhe të kohës me çështjet që tërheqin më shumë vëmendjen e publikut, dhe meqënëse politika është ajo ndër më kryesoret, duket sikur ato nuk gjejnë shumë interes të kthehen nga çështjet e barazisë gjinore dhe diskriminimit të grave për sa kohë që edhe politika nuk është e interesuar për to. Qëndrimi i medias ndaj çështjeve të barazisë gjinore nuk ka qenë paraprijëse e mentalitetit lokal dhe kombëtar, dhe nivelit të politikës në vend. Barazia gjinore dhe diskriminimi i grave mbeten

<sup>26</sup> Sipas intervistës me z. J. Hallaci ( Gazetar në median lokale dhe korrespondent i mediave kombëtare)

<sup>27</sup> Gruaja Shqiptare dhe Problemi i Barazisë gjinore- Studim nga MPCSSHB në bazë të një ankete kombëtare

çështje të domosdoshme për tu adresuar për zhvillimin e shoqërisë dhe demokracisë në vend, megjithëse të gjitha iniciativat gjinore deri në kohën aktuale janë ndërmarre me ndërhyrjen e strukturave dhe organizatave të huaja dhe jo si iniciativa të brendshme të shoqërisë shqiptare. Madje shpesh barazia gjinore është konsideruar si koncept i importuar nga jashtë së bashku me ratifikimin e konventave dhe marrëveshjeve të ndryshme ndërkombëtare dhe jo si fenomen i pranishëm brenda shoqërisë shqiptare. Një mision i rëndësishëm për mediat është që të luajnë një rol avant-gardë në përcjelljen e këtij informacioni tek publiku me qëllim ndërgjegjësimin e tij që deri më tani është vështirë të thuhet jo vetëm për mediat lokale por edhe ato kombëtare.

Në këtë aspekt, bashkëpunimi i medias me OJF-të lokale, në rastin e aktiviteteve ndërgjegjësuese, adresimit të problemit të barazisë gjinore dhe përmirësimin e situatës së gruas, ka qenë më frytdhënës. Nga ana tjetër këto aktivitete nuk kanë mundur të mbushin boshllëkun e krijuar nga mungesa e vëmendjes së strukturave shtetërore ndaj këtyre problemeve, kur është e ditur se burimet financiare të OJF-ve të angazhuara në këtë fushë janë gjithsesi të kufizuara në numër dhe modeste.

### III. KAPITULLI I TRETË: Përfshirja dhe përjashtimi social

#### III.I. Koncepte mbi Përjashtimin Social

Koncepti i përjashtimit social është relativisht i ri në Shqipëri, në të dyja fushat, akademike dhe politike. Nëse ky togfjalësh është i ri sot, nuk do të thotë se nuk ka ekzistuar fenomeni, pavarësisht se çfarë formash apo kuptimi i kanë dhënë atij përmes gjuhës. Ndërsa në Shqipëri përdorimi i këtij koncepti është i vonshëm, në botën perëndimore, përjashtimi, përfshirja dhe kohezioni social, janë tema të rëndësishme të trajtuara gjerësisht nga studiues, institucione dhe organizata ndërkombëtare. Këshilli i Europës ka rishikuar Kartën Sociale Europiane<sup>28</sup> në vitin 1996, me qëllim përshtatjen me realitetin social të krijuar pas viteve 1990. Në këtë kuadër edhe Shqipëria e ka nënshkruar atë në vitin 2002.

Një nga studiuesit më të njohur mbi përjashtimin social është John Pierson, i cili e ka trajtuar këtë çështje si një veprim i shkaktuar nga njerëzit, duke përjashtuar veten e tyre nga shoqëria, përmes veprimeve të tyre dhe vlerave morale të shkelura (Pierson, 2010). Pierson, ka përgjithësuar njerëzit, duke e përcaktuar përjashtimin social si fenomen shoqëror, i cili nëpërkëmbet nga vetë shoqëria kundër saj, duke shkelur vlerat të cilat i kanë krijuar vetë (sikurse ishte karta sociale të cilën e përmendëm më sipër).

Përjashtimi social prek ata individë të cilët nuk kanë mundësi dhe aftësi të marrin pjesë në institucionet publike. Në vetvete përjashtimi social sipas Pierson, përbën edhe një dhunim të standarteve për drejtësi sociale, dhe një pamundësi për të marrë pjesë në mënyrë efektive në politikë (Pierson, 2010)

Përjashtimi social në Kukës nënkupton më shumë se kuptimi i varfërisë, por padyshim varfëria është thelbi pararendës, duke iu referuar mungesës së kushteve ekonomike, sociale, bazisë gjinore, të drejtave kulturore dhe politike, duke e trajtuar konceptin në një aspekt më të gjërë se varfëria materiale, e cila krijon kushtet e favorshme për përjashtim social të grupeve të caktuara. Për pasojë, ky proces ndikon në cilësinë e jetës së individëve dhe kohezionin e shoqërisë.

Përfshirja sociale mund të përcaktohet si e anasjellta e përjashtimit social dhe ka të bëjë me mundësinë e pjesëmarrjes së plotë në aktivitetet normale shoqërore dhe mundësinë për të jetuar me dinjitet dhe pa u penguar nga faktorët e individit.

Gjithashtu, një përcaktim për përjashtimin social që duhet ta konsiderojmë është ai i Julian Le Grand, Profesorit të Politikës Sociale në LSE<sup>29</sup> sikurse vijon: “Një individ (britanik) është i përjashtuar social nëse (a) ai/ajo është rezident në Britaninë e Madhe, por (b) për arsye përtej kontrollit të tij/saj, ai/ajo nuk mund të marrë pjesë në aktivitetet normale të qytetarëve të Mbretërisë së Bashkuar, dhe (c) ai ajo dëshiron të marrë pjesë”(Le Grand, 1998). Sipas këtij pohimi, ne mund të pohojmë se përjashtimi nuk është vullnetar, në momentin kur dikush dëshiron të marrë pjesë dhe diktohet nga një palë tjetër.

<sup>28</sup> Karta Sociale Europiane është hapur për nënshkrim në Torino më 18 Tetor 1961 dhe protokollet e saj. U rishikua më 3 Maj të vitit 1996 në Strasburg, Francë.

<sup>29</sup> LSE (London School Economic) Shkolla Ekonomike e Londrës

Si një veçori e konceptit të përjashtimit social, Atkinson nga LSE futet më thellë në përkufizimin e tij duke përshkruar dy artikuj: “1. Individit nuk merr pjesë për arsye përtej kontrollit të tij/saj, dhe 2. Ai/ajo dëshiron të marrë pjesë” (Atkinson, 1998:45). Por nëse dikush shtron pyetjen se, cili do të mund të ishte problemi me përjashtimin vullnetar, në këndvështrimin tonë, përjashtimi social vullnetar dhe jovullnetar kanë ndryshime dhe problemi i përjashtimit vullnetar është se ai ndikon në zhvillimin dhe bashkëpunimin e aktorëve të atij komuniteti për një solidaritet social.

### **III.II Ndikimi i varfërisë në përjashtimin social të grave në Kukës**

Sipas përkufizimeve të mësipërme kuptuam se një nga elementët më të rëndësishëm që ndikojnë në përjashtimin social është varfëria, të ardhurat e pakta, mungesa e edukimit cilësor dhe aplikimit të edukimit joformal. Shqipëria prej vitit 1991 deri në vitin 2005, bazuar në të gjitha raportet e institucioneve ndërkombëtare si UNDP dhe BB kanë treguar se vendi ynë ka qenë më i varfëri në Europë.

Në Shqipëri pas vitit 1990, të dy karakteristikat e varfërisë përmendur më sipër kanë egzistuar për zona të ndryshme, sidomos për zonat veriore të vendit. Sipas një studimi të kryer nga INSTAT, BB dhe UNDP në vitin 2002, niveli i varfërisë ishte 25.4% në shkallë vendi, ndërsa në vitin 2005 u zvogëlua në 18.5% dhe në vitin 2008 ra në 12.4%(INSTAT, 2008).

Nëse shohim raportin e UNIFEM të vitit 2009, duket se situata nuk ka ndryshuar shumë për sa i përket nivelit të varfërisë në vendet malore dhe kryesisht për shërbimet sociale, të cilat duhet të kishin ndodhur në sinkron me shpërndarjen e shërbimeve sociale tek pjesa e varfër e shoqërisë, duke identifikuar nivelin e lartë të varfërisë dhe pabarazinë sociale, një nga çështjet për të cilat ka patur strategji kombëtare që prej vitit 2002 për të adresuar këto çështje, por që shumë pak është bërë (UNIFEM, 2009:7).

Gratë në Qarkun e Kukësit, janë një nga grupet që vuajnë më shumë nga pasoja e tranzicionit social dhe ekonomik. Pabarazia gjinore, mbetet një shqetësim si rezultat i traditës gjinore dhe mendësisë mashkullore të shoqërisë, duke e vënë një pjesë të grave në dilemë për përmbushjen e përgjegjësisë familjare apo për karrierë. Nëse i referohemi studimit të UNIFEM (2009) mbi gjendjen social – ekonomike të grave në Bashkinë Kukës, do të kuptojmë se përveç përjashtimit, mentalitetit dhe traditave që egzistojnë në këtë zonë, ata përballen edhe me vështirësitë ekonomike, duke u përjashtuar me ligj nga përfitimi i ndihmës ekonomike (NE).

Ligji për NE dhe shërbimet sociale ndër të tjera shprehet se: “Një familje nuk përfiton NE nëse kanë të paktën një anëtar të familjes i cili; është jashtë shtetit për arsye përveç edukimi, trajtim mjeksor, punë diplomatike apo funksion në ndonjë organizatë ndërkombëtare” (Ligji Nr. 9355, 2006). Ky është një rast i pastër kur vetë ligji përjashton qytetarët e tij në nevojë nga shërbimet për të cilat kanë nevojë, pasi ka raste të shumta që pjestarët e familjeve të cilët raportohen jashtë vendit, mund të jenë të humbur, në burg, të divorcuar pa shkurorëzim në gjykatën e rrethit për shkak se jetojnë jashtë, ose kryefamiljarë të cilët jetojnë jashtë por janë të papunë dhe familja e tyre këtu nuk përfiton nga NE.

### III.III. Përfshirja e grave në vendimarrje;

Pjesëmarrja e grave në qeverisje me mjete të ndryshme demokratike është e rëndësishme për përfaqësimin më të mirë të këtij grupi duke ndikuar në zhvillimin e demokracisë dhe promovimin e vlerave qytetare.

Qytetarët njëloj duhet të kenë akses në qeverisje dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre pa dallim race, gjinie, origjine apo kulture. Ligji parashikon drejtësi dhe barazi formale për të gjithë qytetarët, megjithatë kjo është e pamundur të sigurohet për të gjithë qytetarët, nëse ata nuk janë de facto pjesëmarrës në qeverisje. Pavarësisht ligjit, pjesëmarrja e grave në vendimarrje në Qarkun e Kukësit ka qenë në nivelet e ulëta dhe një rekord në Shqipëri. Në të gjithë rrethin e Kukësit me 14 Komuna dhe 1 Bashki për periudhën 2007 -2011 nuk ka patur asnjë këshilltar femër kur numri i këshilltarëve kalonte 200, dhe asnjë i zgjedhur si drejtues Komune apo Bashkie nuk ishte grua. Pas zgjedhjeve të vitit 2011, në këshillin bashkiak Kukës, nga 25 anëtarë vetëm 2 janë gra. Nuk mund të ketë një përfaqësues nga një grup tjetër i cili nuk bën pjesë në lagjet e pafavorizuara dhe të mbrojtë interesat e tyre, sikurse nuk mund të përfaqësojë asnjë burrë interesat e grave më mirë se ato vetë. Suzane Dovi, nga Universiteti i Arizonës, e ka trajtuar çështjen e grupeve historikisht të papërfaqësuara dhe thekson faktin se vetëm anëtarët e grupit historikisht të pafavorizuar mund të kenë një vizion të përbashkët për të nxitur zhvillimin e komunitetit të tyre (Dovi, 2004).

Pavarësisht ligjit për barazinë gjinore dhe kuotave 30% të pjesëmarrjes së grave në politikë, në rrethin e Kukësit nuk është akoma e mundur të respektohet kjo kuotë dhe ky ligj. Pavarësisht fushatave që janë bërë nga shoqëria civile dhe mediat në përgjithësi mbi çështjet gjinore, nuk ka mundësi përfshirje të këtij grupi në vendimarrje. Nëse në zonat urbane, trendi është në rritje, zonat rurale dhe periferike mbeten një problem dhe gratë aty janë edhe më shumë të përjashtuara dhe të papërfaqësuara. Në 5 vitet e fundit ka pasur iniciativa të mbështetura nga donatorë të ndryshëm ku mund të përmendim UN Women apo UNDP të cilët kanë adresuar çështjet e barazisë gjinore dhe fuqizimit të gruas, edhe në aspektin vendimarrës, duke ofruar asistencë financiare dhe teknike, programeve dhe projekteve lokale për barazinë gjinore. Shoqata “Rinia në Sipërmarrjen e Lirë” (RSL) ka zhvilluar iniciativa të tilla duke shërbyer si aktor i fuqishëm interesi në funksion të advokimit për çështjet gjinore dhe të përfaqësimit gjinor. Një iniciativë e tillë ka qenë monitorimi i zgjedhjeve lokale dhe ato kombëtare në aspektin gjinor. Është monitoruar pjesëmarrja e gruas në votime dhe takime elektorale, duke vlerësuar hapësirën që ju është lënë grave në programet elektorale të partive politike dhe programeve të kandidatëve. Në procesin e monitorimit të zgjedhjeve lokale të Majit 2011, me mbështetjen e UN Women dhe UNDP shoqata RSL angazhoi monitorues në 19 qendra të ndryshme votimi në të gjithë Qarkun e Kukësit, me qëllim monitorimin e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në votime si dhe atyre komisionere të qendrave të votimit. Nga raporti i monitorimit rezultoi se vetëm 8 qendra votimi në të gjithë qarkun kanë pasur në përbërje të komisioneve të tyre të votimit komisionere gra, nga këto 8 qendra, 6 prej tyre kanë pasur nga një grua komisionere dhe 2 qendra votimi të cilat kishin 2 gra komisionere. Në total, ishin 123 komisionerë burra dhe 10 komisionere gra, pra 7,5% e

komisionerëve kanë qenë gra. Vlen për tu përmendur fakti që komisioneret gra kanë qenë anëtarë të forcave politike dhe jo të pavarura. Gjithashtu një element tjetër që doli në pah gjatë procesit të monitorimit ishte pjesëmarrja e ulët e grave në takimet elektorale, kjo e theksuar më shumë në zonat rurale, dhe takime ku diskutoheshë për politika dhe programe për zgjidhjen e problemve pa përmendur shqetësimet e grave.

Përfaqësimi i grave në nivel lokal edhe në forumet e partive politike mbetet shumë i ulët, përveç forumeve të grave të cilat funksionojnë në mënyrë formale (edhe ky në nivel rrethi, pasi në komuna nuk janë egzistuese fare). Forumet e partive lokale janë shumë të varfëra për nga pjesëmarrja e grave, edhe ato pak gra të cilat janë pjesë e partive politike si anëtare apo strukturave drejtuese në raste shumë të rralla, nuk zotërojnë pushtet për të ndikuar në vendimarrje në këto forume lokale.

Në Kukës, gratë e përfshira në politikë, shfaqen vetëm gjatë fushatave elektorale, në tryezat politike që organizohen, duke qenë më së shumti në rolin e dëgjueseve apo të të ftuarve për të krijuar një figurë të re, apo për të treguar se këto forume kanë edhe gra në rradhët e tyre.

Gjatë anketimeve të kryera në terren rezulton se perceptimi i shkaqeve të prapambetjes së zhvillimit dhe fuqizimit të grave në fushën e biznesit dhe të politikës është pasojë e mentalitetit tradicional dhe mungesës së mbështetjes nga familja. Të dy grupet meshkuj dhe femra të pyetur, mendojnë se është detyrë e grave të merren me punët e shtëpisë, ndërkohë që burrat sigurojnë të ardhura. Gjithashtu edhe perceptimi për përfshirjen e grave në aktivitete biznesi apo politike është gjithashtu shumë e ulët si mes meshkujve dhe mes femrave. Në zonat rurale kjo duket një çështje e rëndësishme dytësore, dhe për të cilën banorët së bashku me strukturat përgjegjëse shtetërore lokale duket se e kanë mënjanuar totalisht nga vëmendja.

Në anketat e zhvilluara gjatë këtij studimi, është interesant fakti përse i përket përgjigjes: Nëse është e lirë apo jo gruaja të marrë pjesë në forume politike? Meshkujt shprehën se gratë nuk janë të lira të merren me politikë, dhe se ato kanë punë më të rëndësishme sesa politika, sikurse është familja dhe punët e shtëpisë. Ndërsa vetë gratë, pohojnë se nuk u del kohë dhe se nuk janë të lira nga familja dhe shoqëria, e cila ka krijuar barriera të ndryshme ndaj gruas në Kukës. Shumica e tyre mendojnë se gratë nuk janë të lira për t'u marrë me politikë, por sigurisht perceptimi i konceptit të lirisë mbetet subjektiv. Gjithsesi numri i madh i atyre që kanë dëshmuar për mungesë të lirisë së gruas për angazhim politik, tregon për ekzistencën e barrierave të forta dhe prezente për të dyja grupet gjinore që do të kërkojnë kohë dhe angazhim maksimal nga ana e shoqërisë civile, strukturave politike për ndryshimin e balancës gjinore në vendimarrje.

Përveç lirisë për të marrë pjesë në forumet politike, gjatë intervistave dhe fokus grupeve të zhvilluara gratë janë shprehur gjithashtu se një pengesë tjetër për pjesëmarrje është edhe mungesa e besimit tek qeverisja vendore, drejtuesit e saj politik dhe injorimi që u bëhet grave në lidhje me interesat e grave, duke qenë se burrat kanë të gjithë pushtetin për të marrë vendimet në nivel lokal në rrethin e Kukësit; tjetër pengesë për pjesëmarrje është edhe humbja e interesit të grave për të marrë pjesë në zgjedhje si dhe korrupsioni dhe vendimet arbitrare në qeverisjen vendore. Gratë janë shprehur gjatë fokus grupeve se burrat janë shumë më lehtë të



korruptueshëm sesa gratë, dhe kjo u përshtatet disa drejtuesve të korruptuar, prandaj dhe nuk ju intereson që gratë të jenë në pozicione drejtuese, pasi do të ishte më e vështirë të korruptohen.

Premtimet e shumta që të zgjedhurit bëjnë gjatë fushatave zgjedhore, dhe mosmbajtja e tyre, ka humbur në nivel shumë të lartë interesin qytetar në përgjithësi për të marrë pjesë në zgjedhje, apo edhe në forumet politike nga ana e grave, të cilat kanë qenë të papërfaqësuar si duhet në nivel lokal.

Shqetësimi i ngritur në këtë studim, bëhet për faktin se mungesa e përfaqësimit të grupeve të përjashtuara – sikurse janë gratë në Kukës – nuk krijon mundësi për një përmirësim të kushteve të jetesës së tyre, ndërkohë që përdoren vetëm gjatë fushatave elektorale, shpesh mund edhe të flasin në emër të tyre, por në realitet nuk bëjnë përpjekje për të zgjidhur problemet e tyre.

Çfarë mjetesh mund të kenë gratë, në rrethin e Kukësit, të cilat vijnë kryesisht nga familje të varfëra për t'iu kundërvënë pushtetit politik, i cili ka shumë gjasa të ketë edhe atë ekonomik? Në fakt mjetet demokratike të parashikuara me ligj, të cilat mund t'i përdorin këta banorë nuk mungojnë, por problemi qëndron tek kultura demokratike për t'i përdorur këto mjete dhe tek besimi i munguar për të zgjidhur problemet përmes ligjit apo procesit demokratik, kur në vendin tonë, tranzicioni i gjatë ka treguar se mjetet demokratike nuk përdoren për të zgjidhur situatat normale.

Nëse flasim për demokratizim, dhe nivel përfaqësimi të grupeve të ndryshme të shoqërisë, duhet të pohojmë, se në qeverisjen vendore në Kukës, mungon demokratizimi, pasi kemi mungesë përfaqësimi të një grupi i cili përbën gjysmën e popullsisë (gratë), dhe për pasojë janë të përjashtuara nga vendimarrja. Për sa kohë grupet shoqërore të përjashtuara historikisht nga vendimarrja nuk do të përfaqësohen politikisht, funksionimi i demokracisë nuk do të jetë i konsoliduar, ndërsa përjashtimi social do të vazhdojë të mbetet problem i pashmangshëm për të njëjtët banorë të këtij rajoni.

#### **III.IV. Politikat sociale për përfshirjen e grave në nivel vendor**

Për sa i përket politikave sociale për përfshirjen e grave në nivel vendor, dhe nëse bëhet fjalë për në Kukës, ato nuk egzistojnë as në nivel Qarku dhe as në nivel Bashkie/Komune. Ndërsa në nivel kombëtar ka pasur një Strategji Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2007-2010, në nivel lokal kjo strategji nuk ka funksionuar, të paktën kur flasim për Kukësin. Nëse trajtojmë; Balancën Gjinore në vendimarrje, Fuqizimin ekonomik të gruas, Kujdesi social apo Kujdesin shëndetësor, si pjesë të rëndësishme të kësaj strategjie, në Kukës, të gjithë këto komponentë i mungojnë politikave lokale dhe nuk janë të arrira sikurse i trajton strategjia kombëtare për Barazi Gjinore dhe Dhunën në Familje. Gjatë anketimit kur u pyetën nëse kanë përfituar nga politikat sociale apo nëse kanë dijeni për politika në nivel lokal, 80% e të anketuarve u shprehën se nuk kanë dijeni për politika sociale, dhe 70% e të anketuarve gra nuk kanë përfituar nga këto politika sociale. Në përgjithësi të anketuarit nuk ishin në dijeni të planeve strategjike apo dhe dokumenteve që mbështesin barazinë gjinore.

Strategjia Kombëtare parashikon mbrojtje sociale për kategori të ndryshme, sikurse janë familjet me shumë fëmijë, për familjet rome, egjiptiane, familjet me fëmijë jetimë, por në realitet mbështetja financiare që u jepet këtyre familjeve është e papërfillshme për të krijuar kushtet minimale për një jetesë normale. Të anketuarit, shprehen se ndihma ekonomike është e papërfillshme për nevojat bazë të një familjeje, pasi nuk siguron dot as bukën e gojës, pa shkuar më tej me nevojat shëndetësore apo kushtet e higjienës personale.

### **III.V. Të drejtat e grave, legjislacioni, mekanizmat referues; (ref dokumenta dhe ligje)**

#### Dokumenta Shqiptarë në Mbështetje të Barazisë Gjinore

##### Kushtetuta

Në nenin 18 të Kushtetutës (1998) përcaktohet se të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare e filozofike, gjendja ekonomike, arsimore e sociale.

Ky parim gjen zbatim për të gjithë shtetasit, si për burrat dhe për gratë. Në fakt, kjo bën që kushtetuta të cilësohet si neutrale në aspektin e përkatësisë gjinore, (marrjen e gjinisë mashkullore si normë)

#### Ligji Nr.9970, datë 24.7.2008 PËR BARAZINË GJINORE NË SHOQËRI

##### Neni 1

##### Objekti

Ky ligj rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore.

##### Neni 2

##### Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë;
- b) të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet;
- c) të përcaktojë përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore, qendrore dhe vendore, për të hartuar dhe zbatuar aktet normative, si dhe politikat që mbështesin zhvillimin dhe nxitjen e barazisë gjinore në shoqëri.

KUOTA 30 % për pjesëmarrjen e grave

19 Nëntor 2008 – Kuvendi miratoi Kodin e Ri Zgjedhor i cili përfshin edhe vendosjen e kuotës 30 përqind për pjesëmarrjen e grave në politikë. Ky Kod parashikon ndërmjet të tjerave si përcaktim detyrues për të gjitha partitë që të vendosin të paktën 30% gra si kandidatë në zgjedhje.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje  
Në Korrik të vitit 2006, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ndërmori iniciativën për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit. Ky dokument përbën një bazë të rëndësishme politikash e ligjore për progresin drejt barazisë gjinore dhe familjes pa dhunë

#### Dokumenta Ndërkombëtare në Mbështetje të Barazisë Gjinore CEDAW

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas (CEDAW) i kërkon shteteve anëtare të dënojnë diskriminimin e grave në fushat politike, sociale, ekonomike dhe kulturore, si dhe të marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë legjislacionin, për të modifikuar ose eliminuar ligjet, rregulloret, zakonet apo praktikat ekzistuese që konstituojnë diskriminimin e grave. Qeveria shqiptare e ka ratifikuar Konventën në vitin 1993.

#### Deklarata e Pekinit

Në 1995, Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim, e mbështetur nga 180 vende, mbështet veprimet solemne të qeverive, si dhe përfaqëson një përpunim të detajuar të asaj që kërkon zbatimin efektiv të Konventës CEDAW mbi krijimin e mekanizmit kombëtar. Një nga temat kryesore të kësaj platforme është Gruaja dhe Ekonomia.

#### OZHM (Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit)

Deklarata e Mijëvjeçarit, e nënshkruar në Shtator 2000 në mbledhjen e nivelit të lartë të OKB-së, u kërkon vendeve anëtare “të përkrahin barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, si rrugë të frytshme për të luftuar varfërinë. Objektivi i tretë i OZHM-së është: Nxitja e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes së grave në vendimarrje. Objektivi i 11-të: Eliminimi i dallimeve gjinore në organet e zgjedhura dhe postet vendim-marrëse në pushtetin qendror dhe atë vendor.

## IV. KAPITULLI I KATËRT: VLERËSIMI I SITUATËS DHE GJETJET

### IV.I. Mundësitë për të ardhura financiare të grave

Punësimi është një ndër problemet më të mprehta me të cilën lidhen edhe situatat e tjera. Në të gjithë gjatësinë e këtij studimi vihet re nevoja e artikuluar nga të kontaktuarit për mundësi më të mëdha punësimi.

Tregu i punës në qytet dhe në fshat është i ndryshëm për vetë specifikat dhe nevojat e komunitetit për shërbime dhe përkujdesje. Afërsia mes të dyve, pra qytetit dhe fshatit, duket se nuk ndihmon në hapjen e bizneseve të vogla në fshat.

Angazhimi me punë në qytet për gratë, pavarësisht perceptimit paraprak që mund të kemi, se mundësitë janë më të mëdha dhe ku gratë do të kenë mundësi të angazhohen, duket i gënjeshtërt dhe pak i realizueshëm. Gratë në qytet, në masë të madhe, nuk mund të gjejnë një vend pune dhe ta kthejnë atë në një mundësi të angazhimit ekonomik.

Biznesi akoma nuk ka arritur që të thithë krahun e punës së grave ku mundësia e tyre për punësim tradicional mungon. Iniciativa e vetme e vitit të fundit për hapjen e një fabrike këpucësh<sup>30</sup> duket pozitive duke qenë se ka krijuar mundësi punësimi të një grupi prej 80 grash dhe vajzash të reja.

Nëse vërejmë tregun e punës dhe zhvillimin e biznesit në përgjithësi, do të kuptojmë se sektori i shërbimeve si bar-kafe<sup>31</sup>, restorante, hotele etj, është një mundësi angazhimi i grave me punë. Atë që kjo nuk tregon është fakti se për vetë mentalitetin e shoqërisë në tërësi, në asnjë bar-kafe nuk mund të gjesh një vajzë apo grua si banakiere apo kamarjere. Kështu që edhe ky lloj i tregut të punës që në pamje të parë duket me potencial, është përjashtues për gratë.

Administrata shtetërore mbetet një prej burimeve të të ardhurave të qëndrueshme për gratë e angazhuara. Megjithëse numri i grave të punësuar në administratë është pothuaj i barabartë me burrat, gratë janë më shumë të pranishme në fushën e shërbimeve.

Pagesat e papunësisë dhe ndihma ekonomike (NE) janë burime të tjera të ardhurash për familjet dhe për gratë. Numri i familjeve në Qarkun Kukës të cilat përfitojnë NE është 71%<sup>32</sup>. Kjo tregon nivelin e lartë të varfërisë dhe nevojës, por nuk tregon se këto familje të cilat trajtohen me këto lloj pagesash përfitojnë mjaftueshëm për të plotësuar nevojat e tyre. NE varion nga 600 Lekë deri në 750 Lekë<sup>33</sup>. Reformimi i kësaj skeme do të ishte i nevojshëm dhe i domosdoshëm duke marrë parasysh impaktin shumë të vogël të saj. Kjo bëhet edhe më urgjente duke marrë parasysh numrin e lartë të familjeve në këtë skemë<sup>34</sup>.

<sup>30</sup> Ky është investimi i parë privat në Kukës pas më shumë se 20 vjetësh dhe rreth 18 pas mbylljes së ndërmarrjeve prodhuese

<sup>31</sup> Hamendësojmë se në Kukës mund të gjendet numri më i madh i bar-kafe për numër popullsie në Shqipëri

<sup>32</sup> Sipas CENSUS 2011

<sup>33</sup> Ndhma ekonomike përfitohet në bazë të numrit të anëtarëve të familjes ku pagesa varion nga 600 deri 750 për anëtarë sipas moshës.

<sup>34</sup> Bashkia Kukës, 2075 Familje, Komuna Shtiqën 460 familje, Komuna Bicaj 680 familje (shih tabelën 2)

Pagesa e papunësisë përfitohet nga një numër shumë i vogël ish-të punësuarish, për një periudhë prej 1 viti. Më pas nëse nuk punësohesh - kalon në skemën e ndihmës ekonomike.

Si mundësi tjetër ekonomike, siç e përmendëm më lart është edhe puna në bujqësi në zonat rurale. Gjithsesi, kategoria e tokës, sipërfaqja e punëshme- në pronësi të secilës familje dhe kostot shumë të larta të punimeve buqësore bëjnë që të ardhurat prej saj të jenë shumë të vogla. Janë shumë pak ato familje të cilat investohen dhe realisht nxjerrin të ardhura nga puna e tyre.

Për vetë mënyrën e funksionimit, ata të cilët quhen të vetëpunësuar si fermerë pasi kanë në pronësi tokë janë ata të cilët përbëjnë një grup tërësisht të përjashtuar. Shteti i njeh si të punësuar, ndërsa të ardhurat që ata marrin nga puna e tyre në “ferma” janë shumë të vogla.

Remitancat janë një prej elementëve financiarë mjaft të diskutuar në Shqipëri për vetë kontributin në kohë të ndryshme që kanë dhënë në ekonominë familjare shqiptare. Qarku i Kukësit ka një numër të madh të të rinjve, kryesisht meshkuj, të cilët kanë emigruar apo migruar dhe mbështesin familjet e tyre ekonomikisht. Gjithsesi ky trend i emigrimit dhe mbështetja ekonomike nga jashtë është në rënie për shkak të krizës ekonomike në vendet ku ata jetojnë.

Perceptimi nga gratë dhe individë të komunitetit për mundësitë ekonomike të grave është në të njëjtën linjë. Shumica e të intervistuarve pranojnë që kontributi i grave në mbështetje të familjes është i domosdoshëm por mundësitë e angazhimit të tyre janë shumë të vogla.

#### **IV.II. Varfëria**

*Harta e varfërisë në Shqipëri duket e pandryshuar prej mëse dy dekadash. Pavarësisht investimeve të shumta, zonat veriore dhe lindore përbëjnë pjesën më të varfër të shoqërisë shqiptare. Qarku i Kukësit është në vend të parë për sa i përket nivelit të varfërisë, 71.7% e popullsisë përfiton ndihmë ekonomike<sup>35</sup>.*

*Gjeografia ekonomike e vendit, për herë të parë na vjen në mënyrë zyrtare nga INSTAT, duke na treguar se veriu i vendit është më i varfër dhe ka të ardhurat më të ulëta për frymë, në krahasim me qendrën e vendit, e cila ka rreth 20 përqind më shumë të ardhura për frymë se mesatarja e Republikës... Treguesit më të rëndësishëm të nivelit të varfërisë janë përqindja e popullsisë që jeton në varfëri dhe përqindja e popullsisë që jeton në varfëri ekstreme. Bazuar në të dhënat e vrojtimit, rezulton se në 2008, rreth 12.4% e popullsisë jetonte në varfëri absolute (rreth 373,137 persona), nga 25.4% në vitin 2002 (rreth 813,196 persona)<sup>36</sup>*

*Veriu i vendit vazhdon të jetë më i varfër se pjesët e tjera të Shqipërisë. Kjo varfëri është më e theksuar në zonat rurale të disa qyteteve veriore.<sup>37</sup>*

Të dhënat e mësipërme nuk bëjnë gjë tjetër vetëm se provojnë se varfëria është prezente në masë të madhe për zonën e marrë në studim, si në atë rurale dhe në atë urbane. Duke marrë parasysh së në një situatë të tillë grupet vulnerabël janë më të prirura që të ekspozohen ndaj ndikimit të varfërisë, ne besojmë se gratë janë pre e saj dhe mjaft të ndikuara.

<sup>35</sup> <http://news-al.com/shifrat-tronditese-71-e-kukesit-dhe-dibres-jetojne-me-ndihme-ekonomike.html>

<sup>36</sup> <http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/1047099318/titulli/Studimi-Kukesi-rajoni-me-i-varfer-ne-vend>

<sup>37</sup> <http://www.albeu.com/shqiperi/ja-cilat-jane-zonat-me-te-varfera-ne-shqiperi/56821/>

Gjatë monitorimit të fushatës së fundit zgjedhore me mbështetjen e UN WOMEN-UNDP, u vërejt se gratë të cilat kishin varësi ekonomike nga burrat dhe nga burime, të jashtme janë të prirura të mos shprehin zgjedhjen e tyre me anë të votës, por të shprehin vullnetin e të tjerëve. Familjet e mëdha, të konsideruara të varfra janë shënjestër dhe pjesë e manipulimit të fushatave. Gratë në këto familje nuk kanë mundësi të shprehin vullnetin e tyre pasi vendimet janë të marra paraprakisht nga kryefamiljari. Varfëria, kështu, kthehet në mbështetëse të xhenerimit të drejtuesve dhe përfaqësuesve të zgjedhur me një nivel të lartë të pikëpyetjes së legjitimitetit të tyre. Për më tepër, kjo reflektohet edhe tek mungesa e theksuar e vizionit dhe politikave për të mbështetur qytetarët për të dalë nga varfëria.

Gjithsesi, pavarësisht konfirmimit se Qarku i Kukësit është më i varfri në Shqipëri mbetet e paqartë situata se SA të varfër jemi, cilat janë grupet e ndikuara më shumë apo cila është rruga për të dalë nga kjo situatë.

#### **IV.III. Angazhimi në biznes i grave**

Sipas Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR)<sup>38</sup> në qarkun Kukës janë të regjistruar 350 biznese ku 41 prej tyre janë të drejtuar apo bashkëdrejtuar nga gra. Në përqindje 11.7% e bizneseve drejtohen nga gra. Këto të dhëna i përkasin vetëm bizneseve të regjistruara në QKR, pasi ka biznese të vogla të cilat janë të regjistruar në Njësitë e Qeverisjes Vendore përkatëse. Gjithsesi, trendi është i qartë. Kjo tregon se edhe biznesi dominohet nga burrat.

Ndër pengesat kryesore listohen mbështetja ose jo e familjes, vështirësitë për kreditim, angazhimi i cili kërkohet në drejtimin e biznesit si dhe mungesa e informacionit dhe njohurive.

Përveç pengesave të përmendura më lart, duket se nuk ka politika të qarta për orientimin e grave në biznes dhe në ndërmarrje të iniciativave individuale apo në grup.

Një prej fushave ku sipas të dhënave është përqëndruar mbështetja dhe fokusimi i disa aktorëve me programe të vogla, është ajo e punimeve artizanale me dorë të grave. Pavarësisht punës së rëndë fizike, duket se është një treg i cili funksionon dhe nxjerr të ardhura.

Promovimi i modeleve të suksesshme të grave në biznes do të shërbente si nxitje për të gjitha ato që kanë ide të reja dhe iniciativë për t'i zbatuar. Mungesa e prurjeve të reja të grave në biznes në Kukës për dekadën e fundit, reflekton mungesën e angazhimit të tyre, riskun e lartë dhe pengesat që gratë mund të hasin.

#### **IV.IV. Grupet e grave me probleme të veçanta**

Në grupet e grave me probleme të veçanta, sipas trajtimit që i bëhet nga institucionet shtetërore por edhe nga perceptimi që ne kemi për këto grupe, duke marrë parasysh të dhënat dhe gjetjet nga ky studim, do të listonim:

---

<sup>38</sup> Marrë nga QKR, Dhjetor 2011

- Gratë kryefamiljare të cilat kanë përgjegjësinë për kujdesin ndaj familjes si dhe sigurimin e kushteve të nevojshme të pranueshme të jetesës;
- Vajzat nëna<sup>39</sup> të cilat përballen edhe me presionin e opinionit publik përveç vështirësisë së integritit dhe socializimit.
- Gratë me arsim të ulët të cilat janë pothuajse të përjashtuara nga tregu i punës për vetë specifikat e këtij tregu. Gjithashtu, në shumë raste gratë e këtij grupi janë pre e dhunës dhe abuzimit edhe brenda familjes
- Gratë e papuna pavarësisht statusit apo nivelit ekonomik të familjes janë të prirura të jenë të përjashtuara në aspektin social si dhe të vuajnë presionin psikologjik që vjen prej tij. Mungesa e formave të organizuara të grupeve të grave, i bën të varura nga të tjerë si dhe të fokusuar në punët e shtëpisë.
- Gratë familjet e të cilëve përfitojnë ndihmë ekonomike janë të shumta në numër. Duke hamendësuar një mesatare prej 1 grua për familje përfituese të NE, vetëm në zonën e marrë në studim do të kishim rreth 3100 gra pjesë e këtij grupi. Ky është një numër shumë i lartë i grave në rrezik përjashtimi social.
- Gratë e punësuar në bujqësi, për vetë kushtet dhe të ardhurat të cilat sigurohen nga puna e tyre janë të rrezikuara nga përjashtime sikurse; pamundësi integrimi social dhe ekonomik.
- Gratë me aftësi të kufizuar apo ku një anëtar i familjes është me aftësi të kufizuar përballen më vështirësi edhe më të mëdha. Në të dyja rastet, sakrificat është e jashtëzakonshme dhe niveli i përjashtimit është shumë i lartë.

Mungesa e vizionit për integrimin e grave të grupeve të mësipërme, uljen e numrit të tyre si kontigjent i këtyre grupeve, zhvillimi kaotik ekonomik, social dhe politik nuk ka siguruar deri tani elementët bazë të gjithpërfshirjes. Krijimi i kushteve të favorshme për integrimin e tyre mbetet sfida e pjesës tjetër të shoqërisë.

#### **IV.V. Gjetjet nga grupet e fokusuara, intervistat dhe pyetsorët**

Për realizimin e këtij studimi janë organizuar 2 fokus grupe, plotësuar 235 intervista të strukturuar (pyetsorë) si dhe janë realizuar 7 intervista më individë aktiv, njohës të mirë të situatës sociale, ekonomike dhe politike të grave. Më poshtë do të gjeni gjetjet kryesorë nga aktivitetet e mësipërme.

##### **Gjetjet nga Grupet e fokusuara sipas çështjeve**

##### ***Grupi i fokusuar I***

##### ***1. Sigurimi i të ardhurat për nevojat tuaja personale***

Pjesëmarrëset theksuan se burimi kryesor i të ardhurave ishte familja, prindërit (në rastin kur janë vajza) apo nga burri për gratë e martuara. Gratë shtëpiake dhe të papuna ishin të detyruara t'i kerkonin para burrave të tyre për të përmbushur nevojat e tyre, ndërsa ato gra që punonin

<sup>39</sup> Ky fenomen është pak i vërejtur por ekziston

kishin mundësi t'i përballonin shpenzimet e tyre, pavarësisht se rrogën mund t'a dorëzonin në shtëpi tek prindërit apo tek burri.

## **2. Vendimet në familjen tuaj merren nga:**

**a. Ju**

**b. Kryefamiljari**

**c. Së bashku**

**d. Tjetër**

Pjesëmarrëset u shprehën se përgjithësisht vendimet merren së bashku në familje, megjithatë kishte raste për vendime të rëndësishme vendoste kryefamiljari. I njëjti trend marrëdhëniesh brenda familjes shihet edhe nga informacionet e mbledhura me mjete të tjera gjatë studimit. Vendimet merren bashkërisht në shumicën e rasteve, por vendimet e rëndësishme merren nga kryefamiljari.

## **3. Ushtrimi i biznesit dhe angazhimi në të i grave, mundësitë apo pengesat e hapjes së biznesi;**

Të gjitha pjesëmarrëset u shprehën se nuk kishin biznes privat dhe se nuk ishin të motivuara për t'a bërë një gjë të tillë, duke konsideruar gjendjen e vështirë ekonomike të tyre dhe pengesat që hasin për të marrë një iniciativë të tillë. Pengesa e parë që hasnin ata ishte familja, dhe fakti se sa do të aprovohehe nga familja ndërmarrja e një iniciative të tillë. Pengesa të tjera kishin të bënin me vështirësitë që mund të hasë një grua për të marrë kredi dhe për të financuar biznesin e saj, pasi dihet se gratë kanë shumë pak ose aspak akses ndaj pronës deri më sot, pengesë tjetër është mungesa e kohës, opinioni, mentaliteti, padituria etj.

## **4. Mundësia që gratë kanë për të ndikuar në vendimet e këshillit të komunës/bashkisë për probleme të rëndësishme si punësimi apo investimet;**

Gratë u shprehën mjaft skeptike në lidhje me këtë pyetje. Ata përgjithësisht mendonin se gratë nuk mund të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit të komunës/bashkisë pa lejen e burrit. Nëse do të duheshe të adresohesh një problem tek keshilli, këtë gjë mund ta bënte burri, qoftë edhe për gruan.

## **5. Ekzistenca, njohja e iniciativa dhe programeve për punësimin e grave;**

Pjesëmarrëset u shprehën se rrallë herë është diskutuar në komunitet për punësimin e grave dhe kjo ka ndodhur gjithmonë në periudhë fushata zgjedhore, madje edhe atëherë nuk janë pyetur gratë.

## **6. Mbështetja e familjes për gruan në ngritjen e një aktiviteti në sigurimin e të ardhurave;**

Disa nga pjesëmarrëset u shprehën se do të duhej miratimi nga burri për ngritjen e një aktiviteti privat, ndërsa pjesëmarrëset e tjera u shprehën se nëse do të kishin mundësi ekonomike, atëherë patjetër do të kishin mbështetjen e familjes.



### **7. Përfshirja e grave në administratën shtetërore;**

Numri i grave të cilat punojnë në administratën shtetërore, në krahasim me burrat, veçanërisht në nivele drejtuese është i vogël. Gjithsesi ka disa sektorë të cilët dominohen nga gratë, sektorë të cilët fokusohen në fushën e shërbimeve si arësim apo shëndetësi.

### **8. Përfshirja e grave në forumet politike;**

Pjesëmarrëset u shprehën se gratë përfshihen shumë pak në forumet politike, kjo për shkak të mungesës së kohës, mentalitetit, mungesës së mbështetjes si nga familja ashtu edhe nga shoqëria.

### **9. Kërkesat themelore drejtuar pushtetit lokal dhe aktorë të tjerë me ndikim;**

Gratë vendosin në krye të listës së kërkesave të tyre; më shumë mundësi punësimi dhe shërbime sociale gjithpërfshirëse. Në perceptimin e tyre angazhimi me punë si dhe kontributi në familje me të ardhura, përmirëson statusin e tyre social si brenda ashtu edhe jashtë familjes.

## **Grupi i fokusuar II**

### **1. Vështirësitë që gratë/vajzat hasin në kontekstin lokal;**

Pjesëmarrëset u shprehën se një nga vështirësitë qëndron në mospasjen e një tregu të mirëfilltë pune. Ka shumë të rinj kuksianë që diplomohen çdo vit në fusha të ndryshme si ekonomik, juridik etj, dhe nuk gjejnë treg pune në këtë qytet, pasi të vetmet mundësi që ekzistojnë, janë punësimi në administratën shtetërore.

Pnëgesa tjetër qëndron në faktin se të gjithë duan të punësohen në shtet dhe në profesionin e tyre për të cilin kanë studiuar, ndërkohe që vendet janë të kufizuara ose lipset njohja me zyrtarët për të zënë një vend pune, ndërkohe që ka edhe mungesë informacioni për vendet vakante. Nga ana tjetër, vetë femrat e shikojnë të vështirë qasjen ndaj një vendi pune për shkak të mentalitetit të kohës, frikës së përshtatjes me tregun e punës, mungesës së përvojës etj.

Një tjetër problem që doli në pah gjatë diskutimit ishte edhe rasti i hapjes së fundmi në Kukës të një fabrike këpucësh, ku u përmendën kushtet e vështira në të cilat punonin gratë, mungesa e kontratave të punës dhe plotësimit të kushteve minimale në punë, si dhe mungesa e kontrollit nga shteti i cili në përgjithësi nuk funksionon tek sipërmarrjet private.

### **2. Pjesëmarrja dhe angazhimi i grave dhe vajzave në biznes dhe vendimarrjen lokale në Kukës;**

Pjesëmarrëset u shprehën se iniciativa e grave për të hapur një biznes varet shumë nga kapitali fillestar arsimimi, mentaliteti, besimi tek aftësitë e grave, mbështetja e familjes etj.

Nga ana tjetër, pjesëmarrja e grave dhe vajzave në politikë është e kufizuar si pasojë e mungesës së mbështetjes nga familja në rradhë të parë dhe pastaj nga strukturat drejtuese partiake. Gratë vetë nuk mund të jenë të bashkuara si një forcë e vetme, ka konkurrencë dhe barriera mes vetë grave për të angazhuar dhe përfshirë gra dhe vajza të reja në politikë, nuk organizohen trajnime për rritje kapacitetesh për politikanet e reja. Organizatat e grave sipas tyre duhet të bëjnë pjesë të organizmave të tyre edhe modele të reja.

### ***3. Mundësitë aktuale të punësimit që ofrohen për gratë dhe vajzat në Kukës;***

Të gjitha pjesëmarrëset u shprehën se mundësitë e vetme të punësimit që ofrohen aktualisht janë punësimi në administratën shtetërore ose hapja e një biznesi privat të vogël familjar. Megjithatë, në rastin e parë kërkesa mund të jetë shumë e madhe, por vendet janë të kufizuara, ndërsa për të hapur një biznes privat kërkohen shumë sakrifice dhe mbështetje, kapital fillestar, aftësi menaxhuese e drejtuese, mbështetje nga familja, lehtësira në tatime dhe taksa etj.

### ***4. Ndryshimi mes grave/vajzave të punësuara dhe atyre të papunësuara në marrëdhëniet sociale (familje, shoqëri);***

Ndryshimi mes grave/vajzave të punësuara dhe atyre të papunësuara qëndron tek pavarësia ekonomike që fitojnë gratë/vajzat nga familja ose burri. Në të njëjtën kohë gratë dhe vajzat e punësuara kanë mundësi dhe i plotësojnë më mirë nevojat e tyre për arritje dhe zhvillim.

Në perceptimin tonë, gratë e punësuara do të shërbenim më mirë edhe familjes, ku marrëdhëniet do të ndërtohen në të njëjtin nivel por edhe vetë individit, grua dhe të punësuar. Gratë e papuna kalojnë shumicën e kohës duke u marrë me punët e papaguar të shtëpisë të cilat nuk janë të vlerësuara.

### ***5. Perceptimi për të ardhmen, mundësitë që parashikohen për sa i përket punësimit të grave, pjesëmarrjes në vendimarrje dhe në biznes;***

Duke pasur parasysh faktin se sot në administratën shtetërore ka më shumë meshkuj të punësuar se femra, ndërkohë që shkollohen më shumë femra, kjo mund do të sjellë ndryshim në raportin e të punësuarve burrë-grua në të ardhmen. Angazhimi i grave/vajzave në biznes, politikë, vendimarrje në të ardhmen do të jenë në përmirësim, gjithmonë duke kërkuar ndërgjegjësim të vetë grave dhe vajzave, por duke qënë edhe vetë shteti favorizues me politikat e tij.

## **Gjetjet nga intervistat**

**Intervistat u realizuan me 7 gra<sup>40</sup>**, aktore kyçe dhe pjesëmarrëse në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore brenda territorit të Bashkisë Kukës, me qëllim për të marrë opinione dhe këndvështrime të ndryshme mbi situatën socio-ekonomike të grave në Kukës. Intervistat janë

- 
- <sup>40</sup> Intervistuar
  - L Gjana – Drejtoreshë e Qendrës së Shërbimeve Sociale, Bashkia Kukës.
  - T Cengu – Anëtare e Këshillit Bashkiak Kukës
  - T Kërkhaliu – Bizneswoman
  - M Brati – Drejtoreshë e Zyrës Rajonale të Punësimit
  - V Istrefaj – Drejtoreshë e Shoqatës Qendra e Këshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale Kukës
  - L Baja – Drejtoreshë e Organizatës “Gruaja në Zhvillim”
  - Punonjëse Banke private (anonim)

orientuar rreth pyetjeve të mëposhtme, por ka pasur edhe pyetje të tjera që kanë dalë gjatë intervistës<sup>41</sup>:

### ***1. Pjesëmarrja e grave dhe vajzave në biznes dhe vendimarrjen lokale në Kukës;***

Të intervistuarat u shprehën se pjesëmarrja e grave dhe vajzave në vendimarrjen lokale apo në biznes është e papërfillshme, kjo sepse ato nuk luajnë rol vendimarrës dhe nuk llojnë për një përfshirje më të madhe të grave dhe vajzave. Ka vetëm 2 gra drejtoresha në institucione drejtuese shtetërore dhe vetëm 2 gra biznesmene. Gjithashtu mjafton të përmendet fakti që në Këshillin Bashkiak Kukës, nga 25 anëtare vetëm 2 janë gra. Megjithatë kjo vlerësohet pozitivisht krahasuar me zgjedhjet e kaluara, ku nuk kishte asnjë anëtare femër në këshill. Sipas tyre kjo nuk vjen nga mungesa e kapaciteteve, por nga mungesat në kodin zgjedhor e cila më shumë lidhet me moszbatimit të tij siç duhet, si dhe nga mungesa e përkrahjes politike.

Në biznes, pjesëmarrja e gruas konsiston vetëm brenda parametrave të biznesit të vogël.

### ***2. Pengesat që gratë të jenë të suksesshme në politikë apo në biznes në Kukës;***

Të intervistuarat listuan disa faktorë që pengojnë gratë të jenë të suksesshme në politikë dhe biznes. Sipas tyre ajo që i pengon gratë që të jenë të suksesshme në politikë ka të bëjë me mentalitetin e komunitetit dhe mos besimi ndaj grave, pasi mendohet se politika është punë e burrave. Po ashtu vetë gratë e shohin të pamundur përballjen me një botë ku mbizotërojnë meshkujt (mos barazi në përzgjedhje). Faktorë të tjerë që ndikojnë janë lufta politike brenda llojit, paqëndrueshmëria e situatës politike në vend, mungesa e vullnetit të liderëve partiakë, moszbatimi i legjislacionit përkatës dhe mungesa e politikave favorizuese për gratë.

Pjesëmarrja e ulët e grave në biznes ndikohet nga situata e paqëndrueshme ekonomike, niveli i varfërisë, mungesa e iniciativës, mentaliteti, mungesa e një tregu të mirëfilltë shitjeje etj.

### ***3. Ndryshimi mes grave/vajzave të punësuarra dhe atyre të papunësuarra në marrëdhëniet sociale (familje, shoqëri);***

Ndryshimi mes grave të punësuarra dhe atyre të papunësuarra, lidhet me pavarësinë ekonomike, e cila të bën më të fuqishme, të bën më të aftë për të shprehur mendime dhe opinione për çështje të caktura në punë, familje dhe shoqëri. Sipas tyre pavarësia ekonomike i bën gratë/vajzat e punësuarra më aktive në jetën politike, shoqërore e sociale dhe në familje kanë më shumë autoritet. Të papunësuarat kanë varësi morale, ekonomike, psikologjike, ndjehen inferiore.

---

<sup>41</sup> Pyetjet e parashtruara:

1. Cfarë mendimi keni ju për pjesëmarrjen e grave/vajzave në biznes dhe vendimarrjen lokale në Kukës?
2. Cfarë i pengon gratë të jenë të suksesshme në politikë? Po në biznes?
3. Cfarë ndryshimi ka midis grave/vajzave të punësuarra dhe atyre të papunësuarra, në marrëdhëniet sociale? (familje dhe shoqëri)
4. Kush mendoni se është administrator më i mirë në familje, një burrë apo grua? Po në shoqëri, në një biznes apo në drejtim të një institucioni a ndryshon ky pozicion? Nëse po pse ndodh kjo?
5. Si mund të përfshihen gratë më shumë në biznes? Politikë?

Ambjenti social është më i ndryshëm nga ana tjetër, pasi në punë merr më shumë informacion, ke më shumë njohje dhe merr kulturë.

Megjithatë kishte edhe të mendimit se nuk ka ndonjë ndryshim të madh se vetë nga natyra gratë/vajzat janë sociale, janë të përkushtuara për familjen por kujdesen dhe për marrëdhëniet në shoqëri. Ajo që mund të jetë ndryshim ka të bëjë me informacionin që merret. Një grua e punësuar ka më shumë mundësi për të marrë informacione dhe mundësi për tu përballur se sa një grua e pa punë (shtëpiake). Të qenit e punësuar nuk venit aspak përkushtimin e gruas ndaj familjes.

**4. Kush mendoni se është administrator më i mirë në familje, një burrë apo grua? Po në shoqëri, në një biznes apo në drejtim të një institucioni a ndryshon ky pozicion? Nëse po pse ndodh kjo?**

Të intervistuarat u shprehën se nuk janë kundër administrimit nga burrat, por gratë janë më të përkushtuara si ndaj punëve në familje, në shoqëri apo në biznes. Sipas perceptimit të grave, ato janë shumë më pak të korruptueshme, janë serioze dhe u shkojnë gjërave deri në fund me ndershmëri.

Megjithatë, varet nga tipet e njerëzve. Gratë janë të përkushtuara në punë, kanë metodologji pune, kanë komunikim, por gjithmonë varet se sa kopetenca ka ajo për të menaxhuar punën. Gratë në përgjithësi dinë të drejtojnë<sup>42</sup>.

Njëkohësisht u shpreh mendimi se nuk ka gjëra të prera me thikë. Kjo do të thotë se ka burra të suksesshëm në familje pasi shoqëria jonë akoma është e prirur nga kryefamiljari. Por ka edhe gra të zonja, për të drejtuar dhe administruar në familje. Edhe në fushën e biznesit dhe në drejtimin e institucioneve ekzistojnë dy medaljet (ka gra të zonja dhe burra të zotë).

Gruaja menaxhon, planifikon, përcakton drejtimin dhe qëllimet kryesore të familjes. Gruaja në biznes punon, administron, përballet me konkurrencën, me vizionin dhe largpamësinë në sipërmarrjen e vet. Në punët institucionale gratë janë më të pakorruptuara, të sakta, të qeta, të sinqerta, ofrojnë mirëkuptim, taktika dhe strategji frytëdhënëse për zgjidhjen dhe kryerjen e detyrave.<sup>43</sup>

Gjithashtu ekzistonte edhe një pikëpamje tjetër që një grua është administratore më e mirë, sepse njeh më mirë problemet familjare, ka më shumë ndjeshmëri për problemet e fëmijëve, janë më të lidhura me familjen, më të përkushtuara.<sup>44</sup>

**5. Përfshirja me e madhe e grave në biznes; Politikë; në organizatat dhe forumet e grave;**

Të intervistuarat ishin të mendimit se duhet të jenë vetë gratë që duhet të punojnë për një qëllim të përbashkët. Kjo është si një luftë e cila duhet fituar sepse nuk ta dhuron njeri. Sa më shumë organizime për gratë/vajzat, shoqata të cilat duhet të llojnë e bashkëpunojnë sëbashku për një përfshirje sa më të madhe të grave në të gjithë fushat. Nëse do të ketë zbatueshmëri të ligjit dhe kompetenca të plota, nëse politika do të jetë më favorizuese, nëse vetë gratë do të jenë

<sup>42</sup> Sipas M Brati

<sup>43</sup> Sipas T Kërkhaliu

<sup>44</sup> Sipas V Istrefaj

respektuese të ligjeve dhe rregullave, nëse do të kenë mbështetjen nga vetë gratë atëherë mund të rritet përfshirja e grave në politikë dhe organizatat e grave.

Nga ana tjetër gratë mund të përfshihen më shumë në biznes nëpërmjet granteve që mund të jepen nga Zyra e Punës apo Bashkia/Komuna. Stabiliteti ekonomik është një faktor që ndikon, po ashtu edhe pavarësia financiare e grave, ekzistenca e një tregu të sigurt shitjeje etj.

Përfshirja e grave më shumë në biznes apo në politikë mund të ndihmohet nga politikat e shtetit, me ndryshimet e ligjeve që duhet të bëhen në parlament.

- Ndryshimi i kodit zgjedhor;
- Zbatimi i tij;
- Ngritja e komisioneve pranë njësive të qeverisjes vendore për barazinë gjinore;
- Politika për dhënien e kredive të buta, lehtësira tatimore për sipërmarrjet që drejtohen nga gratë;
- Hapje kursesh profesionale për rritjen e kapaciteteve të grave sipërmarrëse;
- Orientimi i biznesit që drejtohet nga gratë drejt burimeve të pashfrytëzuara në zonat rurale;

#### ***6. Vështirësitë me të cilat përballen gratë në Qarkun e Kukësit;***

Papunësia është një nga vështirësitë më të mëdha më të cilën përballen gratë në vendin tonë. Përgjithësisht nuk ka një transparencë të aplikimeve për vende pune ku konkurojnë dhe në shumicën e rasteve merren në punë jo në bazë të meritave, por në bazë të njohjeve apo më keq nëpërmjet rryshfeteve. Duke qenë se gratë nuk mund të arrijnë deri sa të japin rryshfet, atëherë nuk kanë shumë mundësi as për tu përzgjedhur si e denjë për një vend pune.

Vështirësi të tjera lidhen me:

- Mungesën e aktiviteteve sociale;
- mungesa e ambjenteve sociale-kulturore për gratë;
- Akses më i pakët në punësim dhe edukim;
- Shfrytëzimi në mënyrë joproductive i kohës së lirë;
- Ligji i përfaqësimit (ligji nuk i favorizon gratë për pjesëmarrje në politikë, 30% pjesëmarrje - kufizim);
- Mangësi dhe mungesë shërbimesh sociale;
- Puna e papaguar;
- Mentalitet diskriminues;
- Ekzistenca e familjeve të mëdha;

#### ***7. Mundësitë e punësimin që ofrohen për gratë/vajzat në Qarkun e Kukësit;***

Mundësitë janë shumë të pakta. Ka një mungesë të politikave për punësim. Gratë hasin vështirësi në gjetjen e një vendi pune për shkak të paragjykitimit dhe diskriminimit që u bëhet. Për shkak të këtij paragjykimi edhe ato gra që punësohen, - sidomos në biznes - privat janë të vetëpunësuar në biznesin e tyre.

Realiteti qëndron në faktin se mungojnë vendet e lira të punës, si pasojë e mungesës së ofruesve të vendeve të punës, si bizneset, fasonët (këpucë, çanta, rrobaqepsi)

Shpesh haset mospërshtatje e arsimit me tregun e punës.

Megjithatë si mundësi punësimi mund të orientohemi nga:

- Tradita e punimeve tradicionale të qilimave dhe sixhadeve;
- Turizmi;
- Përpunimi i qumështit (hapja e baxheve);
- Fabrika e këpucëve;
- Pasuritë minerale që ka rrethi ynë;

**8. Cili është perceptimi juaj për të ardhmen për sa i përket angazhimit të grave/vajzave në biznes, politikë, vendimarrje apo në lidhje me mundësitë që mund të ofrohen në të ardhmen për punësimin dhe edukimin e grave dhe vajzave?**

a) E ardhmja do ju përkasë grave/vajzave. Ato janë një forcë e madhe, por kërkohet që të gjithë të punojnë dhe të mbështesin ato gra të cilat futen në rrugën e politikës, biznesit. Roli vendimarrës i tyre mendoj se do i shërbente edhe përmirësimit të imazhit negativ që kanë krijuar politikanët e deritanishëm. Numri i sa më shumë grave në politikë, do të zbuste komunikimin e burrave i cili lë shumë për të dëshiruar, sepse një numër i vogël i grave ka bërë që ato të marrin një pamje burrërore për tu përballur me egërsinë mashkullore, gjë e cila karakterizon të gjitha institucionet vendimarrëse në vendin tonë.<sup>45</sup>

b) Nëse politika do të jetë respektuese, nëse nuk do të ketë kufizime në % pjesëmarrjeje, nëse do të kemi stabilitet ekonomik, fuqizim të grave, nëse do të kemi treg të sigurt për produktet që prodhojnë gratë, nëse do të ketë lehtësira në taksa dhe tatime atëhere angazhimi i grave do të jetë edhe më i madh. Nëse femrat janë të zonjat le të jenë të parat. Ne gratë dhe vajzat duhet të krijojmë një opinion pozitiv për pjesën tej të grave, .<sup>46</sup>

c) Mendoj që problemet e angazhimit të grave/vajzave në biznes, politikë, vendimarrje në të ardhmen për punësim dhe edukim do të jenë në përmirësim, gjithmonë duke kërkuar ndërgjegjësim të vetë grave dhe vajzave si dhe një vullnet pozitiv të politikanëve lokalë dhe qëndrorë.<sup>47</sup>

d) Nuk besoj, pasi klasat politike kanë monopolizuar gjithçka.

e) Duhet të përmirësohet legjislacioni që rregullon përfshirjen e grave.<sup>48</sup>

f) Do të vijë në rritje përfshirja e tyre, por uroj që aktorët përgjegjës të bëjnë më shumë që kjo rritje të jetë e kënaqshme.<sup>49</sup>

### **Gjetjet nga Pyetsorët**

- Gjatë këtij studimi janë plotësuar 235 pyetsorë, ku 44 apo 19% janë plotësuar në zonat rurale marrë në studim, dhe 191 apo 81% janë plotësuar në Bashkinë Kukës<sup>50</sup>.

---

<sup>45</sup> Koment nga L Gjana


<sup>46</sup> Koment nga M Brati

<sup>47</sup> Koment nga T Kërkhaliu

<sup>48</sup> Koment nga T Cengu


<sup>49</sup> Koment nga V Istrefaj

- Raporti i të intervistuarve me anë të pyetsorëve është 37 apo 15.5% meshkuj dhe 198 apo 84.5% femra
- Grupmosha e të intersvistuarve është e ndarë si më poshtë:




- Vendimarrja në familje është e ndarë mes anëtarëve të familjes ku 55% apo 129 të intervistuar deklarohen se vendimarrja është e përbashkët dhe 38% apo 89 individë deklarohen se vendimet i merr kryefamiljari. Gjithsesi trendi i kësaj përqindje është i ndryshëm nga zona urbane me atë rurale.

- Të intervistuarit në masë të madhe (61%) shprehen se nuk kanë biznes privat dhe vetëm 15% e të intervistuarve kanë biznes ku është e përfshirë edhe gruaja




<sup>50</sup> Duhet përmendur se Bashkia Kukës përfshin edhe tre fshatra periferik dhe zonën informale e cila për nga karakteristikat i ngjan, fshatit, zonës rurale.

- Sipas angazhimit të të intervistuarve, vërehet diferencë në % e punësimit të grave mes qytetit dhe fshatit. Në fshat kemi 58% të grave të papuna ndërsa në qytet 49% e grave të papuna. Kjo konfirmon nivelin e lartë të papunësisë, pavarësisht shifrave dhe të dhënave kontraditore nga institucionet.




- Sipas të intervistuarve gratë janë *aspak dhe pak të pavarura* nga burrat në një masë shumë të madhe (92%). Vetëm 8% mendojnë se gratë kanë pavarësi ekonomike nga burrat



- Pavarësisht përgjigjeve të mësipërme, në vazhdim vlerësohet në masë të madhe kontributi i mundshëm i grave në sigurimin e të ardhurave dhe mbështetja e familjes për ta bërë një gjë të tillë.






- Ndërkohë ndikimi i grave në vendimet e rëndësishme në këshillat e komunave dhe të bashkive nga përgjigjet duket se është i mundshëm, pavarësisht perceptimit tonë se një gjë e tillë është e vështirë që të ndodhë.



- Punësimi i grave, si një prej problemeve më të adresuara nga të intervistuarit duket se nuk ka qenë në fokus të politikave apo në diskutimin publik të drejtuesve lokal. Duket se është shumë e nevojshme që të diskutohet dhe të ndërmerren veprime konkrete në këtë fushë.


21. A eshte diskutuar ne komunitet per punesim te grave?				
	Meshkuj qytet	Meshkuj fshat	Femrat qytet	Femrat fshat
Shume here	23.33%	14.29%	27.33%	5.41%
Nganjehere	23.33%	14.29%	28.57%	43.24%

Rralle here	20.00%	42.86%	17.39%	27.03%
Asnjehere	23.33%	28.57%	13.04%	10.81%
Nuk e di	10.00%	0.00%	13.66%	13.51%




- Politikat lokale janë të mbështetura në politikat kombëtare. Megjithatë përciptimi i të intervistuarve është që politika dhe programe të tilla nuk janë mjaftueshëm prezente. Prezenca e politikave lokale konfirmohet, por në një masë të madhe vlerësohen si pak apo shumë pak.


24.A ekzistojne politika lokale ose programe te posaçme per perfshirjen e grave ne organet vendimarrëse?				
	Meshkuj qytet	Meshkuj fshat	Femrat qytet	Femrat fshat
Po	20.00%	0.00%	25.93%	16.22%
Pak	33.33%	28.57%	26.54%	29.73%
Shume pak	20.00%	28.57%	11.11%	10.81%
Jo	6.67%	28.57%	12.35%	10.81%
Nuk e di	20.00%	14.29%	24.07%	32.43%



Angazhimi i grave në jetën publike, politike apo biznes duket se kushtëzohet në një masë të madhe prej familjes. Mungesa e ideve apo mos dëshira për tu angazhuar mbeten në masë të vogël.



Mungesa e fushatave ndërgjegjësuese dhe fuqizuese të grave konfirmohen nga të intervistuarit. Kjo duhet të reflektohet si nevojë dhe si rekomandim i rëndësishëm.



## **REKOMANDIME**

### **1. Rritje e pjesëmarrjes së gruas në vendimarrjen lokale**

Mbështetja e rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimarrje duhet të kthehet në një prej iniciativave, politikave dhe programeve të vazhdueshme të aktorëve të ndryshëm. Ne besojmë se askush nuk mund të përfaqësojë më mirë interesin e grupit sesa vetë anëtarët e saj. Barazia gjinore nuk duhet të jetë vetëm diskursi i përditshëm politik por edhe aksion konkret me rezultate të matshme.

### **2. Fuqizimi i autonomisë ekonomike të gruas dhe rritja e kontributit të tyre nëpërmjet rritjes së aksesit në kreditim**

Nga intervistat me punonjës të bankave, rezulton se gratë janë shumë pak të kredituara në krahasim me burrat. Gjithsesi, nesë i referohemi normës së refuzimit që ju bëhet aplikimive për kredi, nuk ka ndonjë ndryshim të madh mes aplikimeve të refuzuara për gratë dhe aplikimeve të refuzuara për burrat.

Kjo do të thotë se natyra e aplikimit për kredi nuk është në funksion të zhvillimit të biznesit apo iniciativave prodhuese, por në shumicën e rasteve, jepen kredi “konsumatore”, për shtëpi apo për shpenzime të tjera për gjithë familjen.

Skemat e kreditimit të grave të cilat kanë apo duhet të hapin një biznes kanë ekzistuar në rajon.<sup>51</sup> Gjithashtu me mbështetjen e Drejtorisë Rajonale të Punësimit janë mbështetur 6 iniciativa të grave vetëm vitin e fundit me shuma nga 800 deri në 2000 USD.

Iniciativa të tilla si dhe lehtësira në kreditim nga bankat do të ndihmonin fuqizimin e grave dhe do të përcjellnin një mesazh të qartë të përpjekjeve për zhvillim të barabartë.

### **3. Njohje e kuadrit ligjor vendas dhe atij ndërkombëtar, politikave dhe angazhimeve lokale si dhe kontributi në përmirësimin e tyre.**

Do të ishte me mjaft interes, që grupet e organizuara të grave, OJF-të që kanë si target gratë, institucionet, si dhe gratë në përgjithësi të jenë të informuara për anën ligjore të përgjegjësisë të gjithsecilit në funksion të përmirësimit të situatës. Njohja e dokumentave ligjor kombëtar dhe ndërkombëtarë do të shërbente si mjet i fortë presioni dhe lobimi për respektimin e detyrimeve që rrjedhin si dhe hartimin e politikave lokale në sinkron me to.

### **4. Fuqizimi organizatave të shoqërisë civile me fokus, target dhe në shërbim të grave dhe iniciativave gjinore;**

Fuqizimi i organizatave me profil të tillë do të ishte një arritje në vetëdijësimin e grave për situatën dhe angazhimin e tyre në përmirësim të saj. Me mbështetjen e këtyre organizatave do të krijohej një partner i fortë dhe i specializuar në adresimin e çështjeve gjinore. Ato do të kthehen në bashkëbisedues të dy paleve; të grave dhe politikbërësve-qëverisje apo partnerë të tjerë.

---

<sup>51</sup> UNDP në bashkpunim me Bashkitë Kukës dhe Krumë gjatë viteve 2007-2009 kanë mbështetur rreth 30 iniciativa private të grave.

Pamvarsisht se në Qarkun Kukës operojnë organizata dhe forume të tilla, më shumë duhet bërë në drejtim të fuëqizimit të tyre dhe diversifikimit të përpjekjeve në funksion të adresimit të ceshtjeve gjinore dhe në përmirësim të situatës.

**5. Hartimi i strategjive dhe politikave lokale ku natyra “pro-gjinore” të jetë objektiv i qartë më vete dhe i realizueshëm.**

Këto politika duhet të synojnë sigurimin e arsimimit, punësimit dhe angazhimit shoqëror jodiskriminues duke hedhur themelet e konceptit të barazisë gjinore në të gjitha fushat. Buxhetimi gjinor apo analiza gjinore e buxheteve dhe investimeve, mbështetje me politika për sektorë strategjik gjinor, ofrimi i shërbimeve me karakter gjithpërfshirës, do të mundësonte afrimin e hendekut mes gjinive. Angazhimi për hartimin e politikave duhet të jetë i gjithanshëm. qeverisja qëndrore dhe lokale, OJF-të, grupet e interesit, partnerët lokal si dhe dokumentat e rëndësishëm kombëtare dhe ndërkombëtarë duhet të konsultohen. Njesitë e qeverisjes vendore nuk duket se kanë kapacitet e nevojshme për hartimin e këtyre politikave. Specialistë dhe njohës të mirë të ceshtjeve gjinore duhet të angazhohen dhe këto politika duhet të targetojnë Bashkitë Kryesore dhe Qarkun në përgjithësi.

**6. Realizimi në vazhdimësi i studimeve të problemeve të barazisë gjinore në funksion të njohjes së thelluar, intensive dhe të qartë të tyre në mbështetje të politikave lokale.**

Institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të angazhohen për hartimin e këtyre studimeve të detajuara. Me interes të madh do të ishte hartimi i studimeve në rang qarku apo edhe më të ngushtë duke marrë parasysh specifikat e problemeve që adresohen dhe mundësinë për të ndikuar në hartimin e politikave lokale. Gjithashtu duhet patur parasysh koordinimi i ndërhyrjes me Qeverisjen vendore dhe bazuar në dokumentat strategjike kombëtarë dhe Ndërkombëtarë.

**7. Mbledhje e të dhënave statistikore gjinore në të gjitha nivelet, për njohjen në thellësi të situatës aktuale nga këndvështrimi gjinor dhe për hartimin dhe implementimin e programeve konkrete lokale.**

Gjatë realizimit të këtij studimi, një prej sfidave kryesore ishte mbledhja dhe analizmi i të dhënave me bazë gjinore. Në shumicën e rasteve ato mungojnë ose janë të paraqitura në mënyra të atillë çka e bën mjaft të vështirë interpretimin gjinor të tyre. Gjithashtu problem mjaft i madh dhe i evidentuar, janë të dhënat kontradiktore të paraqitura nga institucione të ndryshme për të njëjtën çështje. Mbledhja e të dhënave gjinore do të bënte që situata të kuptohej më qartë dhe programimi dhe realizimi i ndërhyrjeve në funksion të përmirësimit të situatës më i efektshëm.

**8. Forcimi i rolit edukativ dhe publicistik të medias lokale të shkruar dhe elektronike, e cila mund të bëhet aleate e fuqishme e çështjeve gjinore drejt barazisë e drejtësisë sociale.**

Pavarësisht se media lokale është pak e zhvilluar dhe media kombëtare dominon kohën mediatike të individëve dhe familjeve, ne besojmë se ashtu siç kanë treguar në bashkëpunimet e

mëparshme dhe aktuale, media mund të ndikojë në përhapjen e shpejtë të iniciativave dhe ndërhyrjeve me bazë gjinore, duke rritur numrin e të informuarve dhe mbështetësve të këtyre ndërhyrjeve.

Rikonceptimi i problemeve gjinore në një spektër më të gjërë ekonomik-politik-social të medias, ku thelbi të jetë barazia mes gjinive dhe barazia mes njerëzve në tërësi, do të bënte të mundur dhe të realizonte atë, që quhet efekti shumfishues ku mesazhi i qartë të arrinte sa më shumë njerëz.

## **9. Aplikimi i praktikave gjithpërfshirëse**

Metoda moderne për konsultim publik dhe pjesëmarrja qytetare në shpërndarjen e shërbimeve në nivel lokal, për shërbime të tilla si strehimi, edukimi dhe shëndeti, me qëllim arritjen e grupeve historikisht të përjashtuar. Ka dy mënyra për të arritur përfshirjen e të varfërve dhe të përjashtuarve: a) duke punuar me drejtuesit e komunitetit, dhe b) përmes OJQ-ve, të cilat mund të jenë më afër me të përjashtuarit social.

## **10. Ndarja e informacionit**

Informim i vazhdueshëm i pjesëmarrësve mbi rezultatet dhe ndikimin e përfshirjes së tyre. Kjo për të shmangur lodhjen nga konsultimet, dhe për të ndërtuar besimin reciprok, duke i bërë të bindur se nuk e humbën kohën kot gjatë pjesëmarrjes në shpërndarjen e shërbimeve dhe se sugjerimet e tyre nuk do të manipulohen.

## BIBLIOGRAFIA

### Studime

Albanian Elections Survey 2008 realizuar nga United Nations Development Fund for Women  
INSTAT, BB, UNDP, (2008) Shqipëria: Trendi i Varfërisë 2002-2005-2008. *Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës*.

Migracioni në Shqipëri-Rregjistrimi i Popullësisë dhe i banesave (2001) Instituti i Statistikave  
MPÇSSHB (2006) “Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013”, Tiranë.

Pierson, J.,(2010) “*Tackling Social Exclusion*”, Oxford: Routledge.

Strategjia kombetare për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje (2007-2010) Ministria e  
Punës dhe Cështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta

Rregjistrimi i popullsisë dhe i banesave-Instituti i Statistikave (2010)

UNIFEM, (2010) Mapping of Economic Aid - Kukës.

Vlerësim i situatës sociale dhe ekonomike në rajonet e Shqipërisë-United Nations Children’s  
Fund (Dhjetor 2000)

### Burime interneti

Atkinson, A.B. and Hills, J. (1998). *Exclusion, Employment and Opportunity*, LSE STICERD  
Research Paper No. CASE004. Available at SSRN: <http://ssrn.com/abstract=1158895> (u pa dt: 3  
Nëntor 2011)

Dovi, S. (2004). *Making Democracy Work for Women*.

[http://americandemocracy.nd.edu/assets/11303/dovi\\_conference.pdf](http://americandemocracy.nd.edu/assets/11303/dovi_conference.pdf)

Profili Ekonomik i Tiranës (Mars 2010), Bashkia e Tiranës online në <http://www.tirana.gov.al/>  
[vizituar në 10/01/12]

Punëve, Cështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta, faqe zyrtare <http://www.mpcs.gov.al/>[  
vizituar në 10/01/12]

Rregjistrimi i popullsisë dhe i Banesave (2011), Instituti i Statistikave, faqe zyrtare  
<http://census.al/> [vizituar në 10/01/12]

### Ligje

Ndryshimet në Kodin Zgjedhor (Miratuar me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008)

Ligji Nr. 9355, ‘Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet sociale’, dt. 10.03.2005, rishikuar Nr  
9602 dt. 28.07.2006.

Instituti i Statistikave, faqe zyrtare <http://www.instat.gov.al/> [vizituar nw 10/01/12]

Ministrisë së Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta, faqe  
zyrtare <http://www.mpcs.gov.al/> [vizituar në 19/01/12]

Intervista dhe të dhëna nga individë dhe institucione lokale



## SHTOJCA

### PYETSORI

1. Vendodhja: Fshat \_\_\_\_\_ Qytet \_\_\_\_\_
2. Nr. i anetareve te familjes \_\_\_\_\_
3. Marrëdhënia me kr/familjarin: \_\_\_\_\_
4. Gjinia: M \_\_ F \_\_
5. Moshë: a) 18 -29, b) 30 - 39, c) 40 – 59, d) 60 e lart
6. Gjendja civile: martuar \_\_ (nr. i femijeve \_\_) beqar \_\_
7. Edukimi: a) pa arsim \_\_ b) 8 vjeçar \_\_, c) I mesëm \_\_, d) I lartë \_\_, e) pa përgjigje \_\_
8. Angazhimi: a) në shkollë \_\_ b) në punë \_\_ (specifiko \_\_\_\_\_), c) I papunë \_\_, d) pension \_\_, e) pa përgjigje \_\_
9. Sa jane te ardhurat mujore në total të *gjithë familjes* tuaj nga të gjitha burimet \_\_\_\_\_
10. Me çfarë i siguron i ardhurat për nevojat *tuaja personale*?  
\_\_\_\_\_
11. A paguani ndonjë nga detyrimet e mëposhtme: Qera banese \_\_, kredi \_\_, gaz \_\_, energji
12. Kush i merr vendimet ne familjen tuaj: Ju \_\_\_\_\_; Kryefamiljari \_\_\_\_\_;  
Se bashku \_\_\_\_\_; Tjeter \_\_\_\_\_
13. Kush i kryen punët e shtëpisë? \_\_\_\_\_
14. A keni biznes privat? Po \_\_, Jo \_\_, Nëse po, kush e drejton a) grua \_\_ b) burrë \_\_\_\_\_;
15. Nese jo a keni menduar ndonjehere te hapni nje dhe cilat jane arsytet qe nuk e keni bere akoma? \_\_\_\_\_
16. Cilat janë pengesat për një grua që të bëjë biznes?  
a) \_\_\_\_\_ b) \_\_\_\_\_ c) \_\_\_\_\_
17. Sa të pavarura ekonomikisht nga burrat janë gratë ne Kukës?  
a) aspak \_\_, b) pak \_\_ c) shumë \_\_
18. Si mund t'ju ndihmoj bashkëshorti në përfshirjen tuaj në sigurimin e të ardhurave? (vetëm për gra)  
\_\_\_\_\_
19. A mendoni se sigurimi i ta ardhurave financiare për fëmijët tuaj është detyrim edhe i gruas?  
a) Po \_\_ b) Jo \_\_\_\_\_

**20.** A mendoni se gratë mund të ndikojnë në vendimet e këshillit komunes/bashkisë në lidhje me punësimin apo investimet?

a) Po \_\_\_ b) jo \_\_\_

**21.** A është diskutuar në komunitet për punësim të grave ?

a) shumë herë b) nganjëherë c) Rrallë herë d) Asnjëherë e) nuk e di

**22.** A egzistojnë politika lokale ose programe të posaçme për përfshirjen e grave në organet vendimarrëse?

a) Po b) Pak c) Shumë pak d) Jo e) nuk e di

**23.** A mund të ketë një grua mbështetjen e familjes në ngritjen e një aktiviteti në sigurimin e të ardhurave financiare ?

a) Po b) Pak c) Shumë pak d) Jo

**24.** A mendoni se gratë janë të suksesshme të administrojnë një aktivitet industrial/bujqësorë?

a) Po b) Pak c) Shumë pak d) Jo

**25.** A janë organizuar ndonjëherë fushata sensibilizuese për përfshirjen e grave në politikë ?

a) Shumë herë b) Nganjëherë c) Rrallë herë d) Asnjëherë

**26.** Sa të përfshira janë gratë e komunitetit tuaj në administratën shtetërore?

a) Shumë b) Pak c) Shumë Pak d) Aspak

**27.** Sa të përfshira janë gratë e komunitetit tuaj në forumet politike?

a) Shumë b) Pak c) Shumë Pak d) Aspak

**28.** A është e lirë nga familja një grua të marrë pjesë në forumet politike? Po \_\_\_ Jo \_\_\_

**29.** Gratë nuk janë pjesë e partive politike dhe anëtarë të këshillit në numër sikur burrat; kjo ndodh për shkak se ato; a) nuk dëshirojnë të angazhohen, \_\_\_ b) nuk i lejon familja \_\_\_  
c. arsye të tjera; \_\_\_\_\_

**30.** Gratë nuk janë pjesë e partive dhe biznesit në numër sikur burrat; kjo ndodh për shkak se ato; a) nuk dëshirojnë të angazhohen, \_\_\_ b) nuk i mbështet familja \_\_\_  
b) nuk kanë ide \_\_\_ e) arsye të tjera; \_\_\_\_\_

**31.** Çfarë do të kërkoni nga organet e pushtetit lokal për gratë?

Komente të tjera

**TABELA 1**

Përfaqësimi gjinor në Këshillat e Komunave pas Zgjedhjeve lokale të 8 Maj 2011

<b>Nr</b>	<b>Bashkia/Komuna</b>	<b>Nr I grave të zgjedhura</b>	<b>Këshilltare Total</b>	<b>rrethi</b>
1	Bashkia Kukës	2	25	Kukës
2	Komuna Bushtricë	3	13	Kukës
3	Komuna Kalis	1	13	Kukës
4	Komuna Ujmisht	1	13	Kukës
5	Komuna Shishtavec	1	15	Kukës
6	Komuna Topojan	1	13	Kukës
7	Komuna Surroj	1	13	Kukës
8	Komuna Tropojë fshat	1	15	Tropojë
9	Komuna Zapod	1	13	Kukës
10	Komuna Bicaj	0	15	Kukës
11	Komuna Shtiqën	0	13	Kukës
12	Komuna Tërthore	0	13	Kukës
13	Komuna Gryk qajë	1	13	Kukës
14	Komuna Arrën	0	13	Kukës
15	Komuna Kolsh	0	13	Kukës
16	Komuna Malzi	0	13	Kukës
17	Bashkia Krumë	0	15	Has
18	Komuna Fajza	0	13	Has
19	Komuna Gjinaj	0	13	Has
20	Komuna Golaj	0	15	Has
21	Bashkia B Curri	6	15	Tropojë
22	Komuna Bujan	0	13	Tropojë
23	Komuna Bytyq	0	13	Tropojë
24	Komuna Margegaj	1	13	Tropojë
25	Komuna Llugaj	1	13	Tropojë
26	Komuna Fierzë	1	13	Tropojë
27	Komuna Lekbibaj	1	13	Tropojë
	Nr total I Grave	23	375	

6%

100%

**Tabela 2**

Zona marrë në Studim

<b>Nr</b>	<b>Njësia e qeverisjes vendore</b>	<b>Popullsia</b>	<b>Nr i familjeve</b>	<b>Nr i familjeve përfituese të NE</b>	<b>Familje përfituese te NE në %</b>
<b>1</b>	Bashkia Kukës	22256	4663	2075	44.5%
<b>2</b>	Komuna Bicaj	6529	1733	840	48.5%
<b>3</b>	Komuna Shtiqën	4128	820	460	56%
	<b>Total</b>	<b>32913</b>	<b>7216</b>	<b>3375</b>	<b>46.8%</b>